



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**

## **RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK**

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave  
“Menaxhim në Inxhinieri”**

**Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti "Metropolitan  
Tirana"**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof Asoc. Etleva Leskaj

2. Dr. Irma Shyle

Prill / 2023

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT****Master i Shkencave në “Menaxhim në Inxhinieri”**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti "Metropolitan Tirana"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti Informatikë Ekonomike
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave “Menaxhim në Inxhinieri”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr.197 datë 28.05.2013
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	–
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër nr.371, datë 23.12.2019
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Vendim i Bordit të Akreditimit nr.15 datë 19.05.2017
8	Cikli i studimit:	Cikli i Dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vjet/4 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Jo
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	7/9 – viti akademik 2022-2023
18	Numri i studentëve:	2020-2021, 12 studentë 2021-2022, 5 studentë 2022-2023, 12 studentë
19	Komente / të tjera:	

## TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti "Metropolitan Tirana" u licencua me vendim Nr. 357, datë 12.05.2010 të Këshillit të Ministrave me statusin e Shkollës Private e Arsimit të Lartë "Universiteti Metropolitan Tirana".

Pas miratimit të statutit me UMASR Nr. 611, date 28.09.2018, institucioni është riorganizuar nga SHPAL në Universitet me UMASR Nr. 195, datë 01.04.2019. Universiteti "Metropolitan Tirana" është akredituar me VBA nr. 45 date 05.07.2019, deri me datë 14.12.2022.

Fakulteti i Ekonomisë është një nga tre njësitë kryesore të Universitetit "Metropolitan Tirana". Ky fakultet synon të arrijë standarde akademike dhe pajisjen e studenteve me dije dhe njohuri praktike të cilat do ti ndihmojnë ata të përballen me tregun kombëtar dhe ndërkombëtar.

Programi i studimit Master Shkencor "Menaxhim në Inxhinieri" është pjesë e programeve të studimit të ciklit të dytë të ofruara nga Fakulteti i Ekonomisë, i cili është hapur me Urdhër të Ministrisë së Arsimit Nr.197, datë 28.05.2013 për hapjen e programeve të studimit "Master i Shkencave në Universitetin Metropolitan Tirana.


Programi i studimeve Master Shkencor "Menaxhim në Inxhinieri" ofrohet në përputhje me vizionin dhe misionin e Departamentit Informatikë Ekonomike. Ky program studimi ka për qëllim tu ofrojë të diplomuarve, kompetenca të avancuara profesionale për formimin e ekspertëve të mirëfilltë në fushën e menaxhimit të projekteve por jo vetëm. Gjithashtu ky program studimi gërsheton njohuri teorike dhe praktike për të inkurajuar te studenti mendimin kritik dhe krijues si dhe për ti ekspozuar ata drejt çështjeve bashkëkohore dhe kyçe në fushën e menaxhimit në fusha të ndryshme të inxhinierisë suke synuar vazhdimisht zbatimin e parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm.

Ky program studimi ofrohet në përputhje me Ligjin 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë" dhe akteve nënligjore në funksion të tij. Studentët e këtij programi kanë mundësinë të zhvillojnë leksionet në ambiente komode, për sa i përket zhvillimit të leksionit, si dhe kanë akses në facilitete si biblioteka, laborator, etj.

Universiteti Metropolitan Tirana është i përfshirë në projekte si dhe është në tratativa për të lidhur marrëveshje me kompani të mëdha në fushën e inxhinierisë, gjë kjo e cila do të lehtësojë procesin e praktikave të studentëve. Specifikojmë se studenti në këtë program studimi është në qëndër të vëmendjes si për departamentin dhe për institucionin që e ofron këtë program. Lektorët parqiten të angazhuar dhe ofrojnë profesionalizën dhe transparencë në punën e tyre.

## SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I MË PARSHËM

Ky program studimi është akredituar me vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 15, datë 19.05.2023,  
me një afat 6 vjeçar, pa rekomandime.



## **Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm;**

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Master Shkencor “Menaxhim në Inxhinieri” ofruar nga Departamenti Informatikë Ekonomike pranë Fakultetit Të Ekonomisë të Universitetit Metropolitan Tirana, filloi me trajnimin, prezantimin si dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm.

Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), filloi shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit, GVJ ka shqyrtuar dhe analizuar mjaft dokumente dhe informacione të përgatitura nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për këtë proces vlerësimi. Gjithashtu një informacion i plotë dhe i detajuar është marrë edhe gjatë vizitës në Fakultetin e Ekonomisë të zhvilluar në datat **07 dhe 08 Shkurt 2023** sipas një agjende të hartuar nga GVJ me asistencën e ASCAL.

Gjatë kësaj vizite 2-ditore, GVJ zhvilloi takime me: Dekanin e FE dhe Përgjegjësën e Departamentit Informatikë Ekonomike, me Zyrën e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, me përfaqësues të Zyrës së marrëdhënieve me jashtë, projekteve / pranimeve dhe këshillimit për karrierën, grupin e vlerësimit të brendshëm (GVB), me stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi me përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore, stafin e Sekretarisë Mësimore si dhe studentët që ndjekin programin e studimit. Gjatë këtij takimi u shqyrtuan çështje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit në fjalë, duke sqaruar edhe elementë të veçantë, për të cilat ishin ngritur pyetje përkatëse.

Pas vizitës në IAL, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm filloi punën për të hartuar raportin e vlerësimit të jashtëm bazuar në dokumentacionin në dispozicion dhe informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitave të realizuara në këtë IAL. Vlerësimet për çdo standard dhe fushë synojnë të paraqesin objektivisht performancën e institucionit në ofrimin e këtij programi studimi.

Procesi është koordinuar nga ASCAL në përputhje me afatet e përcaktuara me të cilat grupi i vlerësimit të jashtëm është njohur që në fillim të angazhimit të tij. Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga Prof. Asoc. Etleva Leskaj dhe Dr. Irma Shyle. Gjatë gjithë këtij procesi GVJ është asistuar nga Erjon Xhako, përfaqësues i ASCAL. Në përfundim të këtij procesi ky grup dorëzon raportin tek eksperti përkatës i ASCAL.

Më datë 05.04.2023, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 10/2 Prot., datë 05.04.2023, dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, me shkresë zyrtare Nr. 59/1 Prot., datë 11.04.2023, ka dërguar përgjigje mbi draft raportin, duke u shprehur se nuk ka komente, si rrjedhojë raporti, merr formën përfundimtare, si raport i vlerësimit të jashtëm.

**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave**  
**“Menaxhim në Inxhinieri”**

**I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT  
 MASTER I SHKENCAVE**

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi “Master i shkencave” në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve” që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i studimit Master i Shkencave “Menaxhim në Inxhinieri” i ofruar nga Departamenti Informatikë Ekonomike në Fakultetin e Ekonomisë (FE), në Universitetin Metropolitan Tirana (UMT), është hartuar duke marrë parasysh traditën e IAL-së, nevojat e tregut të punës si dhe ecurinë e proceve zhvillimore të vendit. Programi synon pajisjen me kompetenca dhe aftësi të nevojshme në menaxhim dhe inxhinieri dhe proceset që lidhen me të dhe nuk bie ndesh me interesat dhe vlerat kombëtare.  <i>Aneksi Nr.09, Rregullore e programit të studimit në “MSc” në Menaxhim në Inxhinieri, neni 7, 8.</i>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit Master Shkencor “Menaxhim në Inxhinieri” është pjesë e programeve të studimit të ciklit të dytë të ofruara nga Fakulteti i Ekonomisë, i cili është hapur me Urdhër të Ministrisë së Arsimit Nr.197, datë 28.05.2013 për hapjen e programeve të studimit “Master i Shkencave në Universitetin Metropolitan Tirana” ( <i>Aneksi Nr.01, Aktet e licensimit dhe akreditimit të programit</i> ). Programi i studimeve Master Shkencor “Menaxhim në Inxhinieri” ofrohet në përputhje me vizionin dhe misionin e departamentit Informatikë Ekonomike. Ky program studimi ka për qëllim tu ofrojë të diplomuarve, kompetenca të avancuara profesionale për formimin e ekspertëve të mirëfilltë në fushën e menaxhimit të projekteve por jo vetëm. Gjithashtu ky program studimi gërsheton njohuri teorike dhe praktike për të inkurajuar te studenti mendimin kritik dhe krijues si dhe për ti ekspozuar ata drejt çështjeve bashkëkohore dhe kyçe në fushën e menaxhimit në fusha të ndryshme të inxhinierisë suke synuar vazhdimisht zbatimin e parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm.  <i>Aneksi Nr.09, Rregullore e programit të studimit në “MSc” në Menaxhim në Inxhinieri, neni 7, Objektivat formues të programit</i>
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje	Programi i studimit ofrohet në përputhje me misionin dhe qëllimin e IAL-së, për formimin akademik të studentëve në fushën e shkencave

Adresa: “Rruga e Durrësit” , Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 6




<p>me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>të aplikuar dhe inxhinierisë, ekonomisë etj. Nga analiza e dokumentacionit dhe vizita në institucion, ky program studimi është në përputhje të plotë me sa më sipër dhe ofron mundësinë që studentët të ndjekin studimet e doktoratës duke rritur mundësitë për diversifikimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të karrierës së tyre profesionale.</p> <p><i>Aneksi Nr.05, Statuti i UMT, Neni 4.Misioni I UMT</i>  <i>Aneksi Nr.09, Rregullore e programit të studimit në “MSc” në Menaxhim në Inxhinieri, neni 7, Objektivat formues të programit</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Ky program studimi pajis studentët me aftësi teorike dhe praktike, i zhvillon njohuritë dhe aftëson studentët në përshtatje me tregun e punës.</p> <p>Gjithashtu ky program studimi gërsheton njohuri teorike dhe praktike për të inkurajuar te studenti mendimin kritik dhe krijues si dhe për ti ekspozuar ata drejt çështjeve bashkëkohore dhe kyçe në fushën e menaxhimit në fusha të ndryshme të inxhinierisë suke synuar vazhdimisht zbatimin e parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm. Ky program studimi synon në përgatitjen jo vetëm profesionale të studentëve por synon gjithashtu në përgatitjen e studentëve për të ndikuar në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit.</p> <p>Vizioni i programit të studimit është të pregatisë “Lidera të mëndimit dhe të veprimit” duke dhënë kështu kontribut në zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë në vend.</p> <p><i>Aneksi Nr.09, Rregullore e programit të studimit në “MSc” në Menaxhim në Inxhinieri.</i>  <i>Aneksi Nr.10, Dosja e programit MSc në MI.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor</p>	<p>Ky program studimi i ofron studentëve kompetenca dhe njohuri në fusha të tilla si:ekonomia, menaxhimi, inxhinieria etj.</p> <p><i>Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga IAL si edhe nga vizita që GVJ pati në institucion, rekomandojmë që programi Master Shkencor “Menaxhim në Inxhinieri” të garantojë formimin dhe aftësimin e studentit për kërkimin shkencor pasi në përbërje të kurrikulës nuk ka lëndë specifike për metodat e kërkimit si edhe një numër i konsiderueshëm kreditesh i alokohen punës së studentit, e cila fokusohet tek tema e masterit e cila konsiston në një kërkim shkencor.</i></p> <p><i>Prezenca e lëndës Metodat e kërkimit shkencor do ta aftësojnë studentitn dhe do ta pajisin me njohuritë e nevojshme për përgatitjen cilësore të punimit të dipomës si edhe do ti përgatiste këta studentë për ciklin e tretë të studimeve.</i></p>

	<i>Aneksi Nr.09, Rregullore e programit të studimit në "MSc" në Menaxhim në Inxhinieri, neni 7, Objektivat formues të programit Aneksi Nr.16, Plani mësimor i programit studimor MSc në MI. Aneksi Nr.18, Plan programet e lëndëvesyllabuset.</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi I.2</b>	
<b>Programi i studimit MSH/MA është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	<p>Bazuar në Statutin e UMT si dhe Planin Strategjik të Zhvillimit të UMT, programi i studimit është hartuar dhe ofrohet në përputhje të plotë me dhe në zbatim të strategjisë për zhvillimin institucional të UT-së. Krahasuar edhe me numrin e studentëve që nga hapja e këtij program studimi, viher re nje rritje e numrit të studentëve të rregjistruar dhe diplomuar në këtë program studimi Master Shkencor Menaxhim në Inxhinieri.</p> <p>Një nga objektivat e institucionit UMT është ruajtja dhe avancimi i profilit të tij në fushën e shkencave të aplikuara, inxhinierisë, ekonomisë etj. Ky program studimi është në përputhje me këtë objektiv dhe e çon përpara atë. GVJ e vlerëson pozitivisht faktin që programi i studimit është në koherencë edhe me Planin Strategjik të Zhvillimit të UMT të vet dhe paraqitet si nevojë pasja në konsideratë të vazhdueshme e ndryshimeve ekonomike, sociale dhe teknologjike që influencojnë direkt nevojat për kompetenca të reja në tregun e punës.</p> <p><i>Aneksi Nr.05, Statuti i UMT.</i>  <i>Aneksi Nr.06, Plani strategjik i zhvillimit të UMT.</i>  <i>Aneksi Nr.76, Lista e Studentëve të diplomuar 2020-2022.</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	<p>Programi i studimit ofrohet dhe zbatohet në përputhje me statutin dhe rregulloren e përgjithshme të IAL-së si edhe atë të njësisë kryesore. Bazuar në Statutin e UMT, Planin Strategjik i Zhvillimit të UMT, sikurse edhe në rregulloren e programit të studimit, programi i studimit synon të formojë specialistë dhe profesionistë në fushën e inxhinierisë si edhe kërkues të rinj të cilët janë të orientuar drejt aktiviteteve akademike dhe kërkimore. Programi është reflektim i prioriteteve të shkruara në statutin e UMT-së dhe rregulloren e programit të studimit.</p>



	<p><i>Aneksi Nr.05, Statuti i UMT.</i>  <i>Aneksi Nr.06, Plani strategjik i zhvillimit të UMT.</i>  <i>Aneksi Nr.09, Rregullore e programit të studimit në "MSc" në Menaxhim në Inxhinieri.</i></p>		
<p><b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave "Menaxhim në Inxhinieri" është i përshtatshëm për nivelin e studimeve të ciklit të dytë si nga forma, përmbajtja ashtu dhe shtrirja kohore. Ky program studimi ka një ngarkesë prej 120 ECTS të shtrirë në një kohëzgjatje studimi prej 2 vitesh (4 semestra) dhe emërtimi i tij është i përshtatshëm sa i përket komunikimit të tij të studentët e synuar. Programi i studimit, është në përputhje dhe vazhdimësi me fushat e drejtimit akademik të institucionit, ato të inxhinierisë dhe ekonomisë. Kjo konfirmohet edhe nga profili i studentëve që zgjedhin këtë master. Nga takimi me stafin e angazhuar në këtë program studimi si edhe me studentët e këtij programi studimi, u konstatua që studentët që ndjekin programin e studimit Master Shkencor në "Menaxhim në Inxhinieri" kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në profilet e Inxhinierisë ose Administrim Biznesi.</p> <p><i>Aneksi Nr.09, Rregullore e programit të studimit në "MSc" në Menaxhim në Inxhinieri.</i>  <i>Aneksi Nr.06, Plani strategjik i zhvillimit të UMT.</i>  <i>Vizita në institucion- takim me stafin dhe me studentët</i></p>		
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit</p>	<p>Programi i studimit është në përputhje me prioritetet kombëtare e rajonale për zhvillim e kurrikulave në disiplinën e Inxhinierisë dhe Menaxhimit, ndërkombëtarizimin dhe përvetësimi i praktikave të mira evropiane dhe atyre globale të kurrikulës janë vendosur si objektiva strategjike si për UMT ashtu dhe ato që lidhen direkt me këtë program studimi.</p> <p><i>Aneksi Nr.06, Plani strategjik i zhvillimit të UMT.</i>  <i>Aneksi Nr.09, Rregullore e programit të studimit në "MSc" në Menaxhim në Inxhinieri.</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X

**Standardi I.3**

**Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**

<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Ky program studimi ka për qëllim tu ofrojë të diplomuarve, kompetenca të avancuara profesionale për formimin e ekspertëve të mirëfilltë në fushën e menaxhimit të projekteve por jo vetëm. Gjithashtu ky program studimi gërsheton njohuri teorike dhe praktike për të inkurajuar te studenti mendimin kritik dhe krijues si dhe për ti ekspozuar atë drejt çështjeve bashkëkohore dhe kyçe në fushën e menaxhimit në fusha të ndryshme të inxhinierisë suke synuar vazhdimisht zbatimin e parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm.</p> <p><i>Aneksi Nr.09, Rregullore e programit të studimit në “MSc” në Mena në Inxhinieri.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Institucioni, GVJ evidenton analizën e tregut për këtë program studimi në të cilën ndër të tjera përmenden edhe kompetencat dhe aftësitë që lidhen direkt me Masterin Shkencor Menaxhim në Inxhinieri.</p> <p><i>Aneksi Nr.12, Studim tregu për programin e studimit në “MSc në MI.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar mbi programin e studimit, rezultojnë se ai synon të kontribuojë në përgatitjen e specialistëve dhe profesionistëve në fushën e menaxhimit në inxhinieri.</p> <p>Programi i studimit zhvillohet në dy vite. Në vitin e parë të diplomuarit realizojnë 60 kredite të shpërndara në 10 lëndë, dhe zhvillojnë lëndët që vijon: Tregu dhe Instrumentat financiare, Menaxhimi I projekteve, Menaxhimi I burimeve njerëzore, Menaxhimi I Përgjithshëm I Cilësisë, Ekonomiks Menaxherial, Trajtimi I të dhënave dhe Vendimarrja, Projektimi dhe menaxhimi is sistemeve etj.</p> <p>Në vitin e dytë, studentët pajisen me 60 kredite. 30 kredite janë të ndara përkatësish nga 6 kredite për lëndët: Programim dhe menaxhim I kantierëve, Sistemet e informacionit të menaxhimit, Menaxhimi I kontratave, Strategji marketingu, Siguria e sistemeve</p>

	<p>të informacionit. 30 kredite janë të alokuara në praktikën profesionale (12 ETC) dhe Mikrotezë (18 ETC).</p> <p>Lëndët bazë të cilat kanë për objektiv të përgatisin studentët nga ana metodologjike përbëjnë 10% të krediteve të programit të studimit.</p> <p>Megjithëse, ky komponent mësimor është në përputhje me VKM nr 41-datë 24.1.2018, <i>GVJ vlerëson që lënda Metodatat e kërkimit shkencor duhet të jetë pjesë e planit mësimor të këtij program studimi sepse përgatit studentët nga ana metodologjike.</i></p> <p>Lëndët karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe përmbyllëse janë konform VKM nr 41.</p> <p><i>Aneksi Nr.09, Rregullore e programit të studimit në "MSc" në Menaxhim në Inxhinieri.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.10, Dosja e programit MSc në MI.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.16, Plani mësimor i programit studimor MSc në MI</i></p> <p><i>Aneksi Nr.38, Plani mësimor sipas llojit të veprimtarisë A-E.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.39, Plani mësimor 2022-2023 për programin Msc në Menaxhim në Inxhinieri.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimit e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Programi i studimit - në strukturë, organizim dhe përmbajtje – është i krahasueshëm me programe të ngjashme të ofruara në IAL në shtete të tjera të Bashkimit Evropian dhe me gjerë. Për më tepër programi i studimit ofrohet me ECTS dhe në përputhje me kërkesat dhe pritshmëritë e zonës evropiane të arsimit të lartë. IAL ka paraqitur të uniformizuar përmbajtjen e lëndëve në përputhje me VKM nr 41 dhe janë bërë përpjekje për të përditësuar literaturën e cila është në ndryshim të vazhdueshëm duke pasur parasysh fushën që mbulon programi i studimit.</p> <p><i>Aneksi Nr.10, Dosja e programit MSc në MI.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.16, Plani mësimor i programit studimor MSc në MI</i></p> <p><i>Aneksi Nr.18, Plan programet e lëndëvesyllabuset.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikatat e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Programi i studimit nuk ka lidhje me profesionet e rregulluara dhe ndjek udhëzimet e hapësirës evropiane të arsimit të lartë të cilat, në shumicën e rasteve, janë të inkuorpuara në legjislacionin vendas për arsyt që janë përmendur më sipër si psh transferimi i studimeve.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" përfshin aftësimin</p>	<p>Në programin e studimit parashikohet praktikë profesionale e cila përbën 10% (12 ECTS) të programit të studimit, në përputhje me legjislacion në fuqi. Në këtë kuadër, Institucioni mbështet studentët</p>

<p>profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>duke ofruar një listë institucionesh partnere për realizimin e praktikave. Nga takimi me studentët rezultoi se praktika zhvillohet në bashkëpunim me subjekte të ndryshme, sipas marrëveshjeve të përbashkëta, të nënshkruara për këtë qëllim. Gjithashtu studentët që punojnë e zhvillojnë praktikën në vendin e tyre të punës. Praktika zhvillohet në bashkëpunim me subjekte private apo publike në funksion të objektivave të këtij programi dhe nën drejtimin e personelit akademik të caktuar për këtë qëllim.</p> <p>Në fund të praktikës studentët plotësojnë një dokument më të gjitha veprimtaritë që ata kanë realizuar dhe marrin vlerësimin përkatës.</p> <p><i>Aneksi Nr.09, Rregullore e programit të studimit në "MSc" në Menaxhim në Inxhinieri.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.17, Dokumentacioni i praktikës për programin e studimit.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.28, Lista e marreveshjeve për zhvillimin e praktikave.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.38, Plani mësimor sipas llojit të veprimtarisë A-E.</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në programin e studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve", duhet të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit.</p>	<p>Programi i studimit Master Shkencor Menaxhim në Inxhinieri ofrohet në gjuhën shqipe. Por marrëveshjet institucionale me IAL jashtë vendit kanë krijuar mundësinë e prezencës së lektorëve të huaj të cilët zhvillojnë mësimin në gjuhën angleze.</p> <p>Gjithashtu në kuadër të ndërkombëtarizimit dhe transferimit të studimeve, njësia bazë ka vënë në dispozicion të palëve të interesuara të gjithë dokumentacionin, ndër të cilat edhe syllabuset e lëndëve edhe në gjuhën angleze. Programet mësimore në anglisht i shërbejnë studentëve në rast transferimi studimesh jashtë shtetit. Po kështu nga konsultimi i CV-ve të stafit të angazhuar në programin e studimit, vihet re një potencial i konsiderueshëm për ta ofruar këtë program studimi në gjuhën angleze. Ofrimi i programit në gjuhën angleze i krijon mundësinë studentëve që e ndjekin atë të punësohen me lehtësi në institucione vendase, por edhe të huaja të cilat operojnë në fushën e Inxhinierisë.</p> <p><i>Aneksi Nr.09, Rregullore e programit të studimit në "MSc" në Menaxhim në Inxhinieri.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.13, Lista e marreveshjeve me IAL-të nderkombetare dhe kombetare.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.16, Plani mësimor i programit studimor MSc në MI Annex No. 18, Course plansyllabuses.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.25, Lista e lektorëve të huaj.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.54, CV e stafit akademik të programit.</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Për programin studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve", institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë</p>	<p>Dokumentacioni për këtë program studimi është në gjuhën shqipe ashtu sikurse ofrohet.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 12

dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze	<p>Dokumentacioni që ka lidhje me ndërkombëtarizimin – aplikime, leksione të përbashkëta, Cv e stafit, marrëveshjet e bashkëpunimit etj. – është edhe në gjuhën angleze.</p> <p><i>Aneksi Nr.07, Rregullore e UMT.</i>  <i>Aneksi Nr.08, Rregullore e FE-UMT.</i>  <i>Aneksi Nr.09, Rregullore e programit të studimit në “MScr” në Menaxhim në Inxhinieri.</i>  <i>Aneksi Nr.20, Rregullore e arkives.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>X</b>

#### Standardi I.4

**Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>UMT ka një përvojë 12-të vjeçare në ofrimin e studimeve universitare në fushën e ekonomisë, Inxhinierisë dhe shkencave të aplikuara. IAL ka krijuar struktura ndihmëse, këshilluese, monitoruese (NJSBC) për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Ndërkohë, programi i studimit Master Shkencor Menaxhim në Inxhinieri, menaxhohet nga Koordinatori i Programit të Studimit i cili zgjedhet nga përgjegjësi i departamentit.</p> <p>GVJ e vlerëson pozitivisht praninë e koordinatorit (përgjegjësit) të programit të studimit i cili përfaqëson një person të dedikuar që bashkëpunon dhe koordinon të gjitha aktivitetet që lidhen me programin e studimit me strukturat e tjera përgjegjëse.</p> <p><i>Aneksi Nr.05, Statuti i UMT</i>  <i>Aneksi Nr.09, Rregullore e programit të studimit në “MScr” në Menaxhim në Inxhinieri (neni 12)</i>  <i>Aneksi Nr.62, Rregullorja e NJSBC.</i>  <i>Aneksi Nr.43, Lista e përgjegjesave të programeve studimore.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas</p>	<p>Fusha e përgjithshme dhe ajo specifike e programit të studimit është në përputhje të plotë me fushën akademike dhe punën kërkimore të personelit akademik dhe njësisë bazë të FE. Ofrimi i programit të studimit është tërësisht në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë kryesore. Gjithashtu, ky program është në përputhje me legjislativonin e arsimit të lartë në fuqi, me Statutin dhe aktet e tjera rregullatore të UT-së.</p> <p><i>Aneksi Nr.05, Statuti i UMT</i></p>

direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	<p><i>Aneksi Nr.08, Rregullore e FE-UMT.</i>  <i>Aneksi Nr.09, Rregullore e programit të studimit në "MSc" në Menaxhim në Inxhinieri</i>  <i>Aneksi Nr.10, Dosja e programit MSc në MI.</i></p>		
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje</p>	<p>Gjithashtu fusha e përgjithshme është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të Departamentit të Informatikë Ekonomike, i cili është përgjegjës për programin e studimit. Ky program studimi i përket nivelit të 7-të të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, dhe bazohet në standardet dhe parimet e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë.</p> <p><i>Aneksi Nr.05, Statuti i UMT</i>  <i>Aneksi Nr.08, Rregullore e FE-UMT.</i>  <i>Aneksi Nr.09, Rregullore e programit të studimit në "MSc" në Menaxhim në Inxhinieri</i>  <i>Aneksi Nr.10, Dosja e programit MSc në MI.</i>  <i>Aneksi Nr.88, Lista e programeve të studimit që ofron FE në Universiteti Metropolitan Tirana.</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi I.5</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p> <p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p> <p>UMT ka miratuar statutin e tij ku sanksionohen njësitë ndihmëse, përgjegjëse për sigurimin e cilësisë, marrëdhëniet me jashtë, kërkimit shkencor dhe IT-së, marrëdhëniet me publikun, burimet njerëzore etj.</p> <p>Në fund të vitit akademik, por jo vetëm, edhe gjatë vitit akademik, në nivel departamenti analizohet procesi i mësimdhënies dhe ecurorisë së programit të studimit. Gjithashtu, në fillim të cdo viti akademik, përcaktohet Plani Vjetor i Punës në FE.</p> <p>Po kështu, secili prej pedagogëve të angazhuar në programin e studimit në fund të vitit akademik plotëson formularin për aktivitetin akademik dhe profesional dhe dorëzon një plan për vitin e ri. Ky dokumentacion përbën bazën vlerësimi të punës, ndarjes së detyrave dhe planifikimit të veprimtarive.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 14

	<p><i>Aneksi Nr.05, Statuti i UMT, neni 8.</i>  <i>Aneksi Nr.24, Organigrama e UMT.</i>  <i>Aneksi Nr.29, Raport vjetor i aktiviteti mësimor, kërkimor dhe shkencor- FE Viti 2021-2022.</i>  <i>Aneksi Nr.32, Plani Vjetor i Punës në FE për vitin 2022- 2023.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>UMT ka bashkëpunime dhe marrëveshje bashkëpunimi me institucione/ kompani publike për zhvillimin e praktikave profesionale dhe aktiviteteve të tjera me profil akademik në fushën e ekonomisë, financave dhe e inxhinierisë. Për këtë program studimi, 45 subjektet bashkëpunuese i përkasin sektorit publik, privat, sektorit financiar etj.</p> <p>Përsa i përket marrëdhënieve me jashtë, UMT, ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi në kuadër të programit Erasmus Mobility me 24 Universitete në BE si dhe jashtë saj sikurse edhe 2 marrëdhënie bashkëpunimi në kuadër të seminareve. Gjithashtu UMT ka marrëdhënie bashkëpunime edhe me Institucione të Arsimit të lartë në vend.</p> <p><i>Aneksi Nr.13, Lista e marreveshjeve me IAL-të nderkombetare dhe kombetare.</i>  <i>Aneksi Nr.25, Lista e lektorëve të huaj.</i>  Aneksi Nr.26 Lista e universiteteve bashkëpunuese në kuader të programit ERASMUS.  <i>Aneksi Nr.28, Lista e marreveshjeve për zhvillimin e praktikave.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Siç është përmendur edhe më sipër, institucioni ka marrëdhënie bashkëpunime me institucione publike dhe subjekte private për zbatimin e praktikave studentore por edhe për shkëmbimin e eksperiencave dhe zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta. Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me IAL jashtë vendit në kuadër të programit Erasmus jo vetëm për stafin akademik por edhe për studentët. Një tjetër element që e lehtëson, punën e institucionit, është se shumica e studentëve të programit janë të punësuar, para ose gjatë periudhës që ata regjistrohen në program.</p> <p><i>Aneksi Nr.13, Lista e marreveshjeve me IAL-të nderkombetare dhe kombetare.</i>  <i>Aneksi Nr.26 Lista e universiteteve bashkëpunuese në kuader të programit ERASMUS.</i>  <i>Aneksi Nr.27, Lista e shkëmbimeve të studentëve në kuadër të Programit ERASMUS.</i>  <i>Aneksi Nr.28, Lista e marreveshjeve për zhvillimin e praktikave.</i>  <i>Aneksi Nr.55, Lista e shkëmbimeve të stafit në kuadër të Programit ERASMUS.</i></p>

	<i>Ref. Takimi me studentët, takimi me stafin akademik.</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.	<p>UMT ka bashkëpunime dhe marrëveshje bashkëpunimi me institucione/ kompani publike për zhvillimin e praktikave profesionale dhe aktiviteteve të tjera me profil akademik në përputhje me programet e studimit që institucioni ofron. Për këtë program studimi, 45 subjektet bashkëpunuese i përkasin sektorit publik, privat, sektorit financiar etj.</p> <p>Në nivel institucional janë përcaktuar rregullat dhe procedurat për ndjekjen e praktikës profesionale.</p> <p><i>Aneksi Nr.17, Dokumentacioni i praktikës për programin e studimit.</i> <i>Aneksi Nr.28, Lista e marreveshjeve për zhvillimin e praktikave.</i></p>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.	<p>Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me IAL jashtë vendit në kuadër të programit Erasmus jo vetëm për stafin akademik por edhe për studentët. Gjithashtu, traditë e institucionit është bërë edhe ftesa ndaj pedagogëve të huaj të cilët kanë ekspertizën dhe profesionalizmin në fusha të ndryshme të lidhura me këtë program studimi.</p> <p><i>Aneksi Nr.25, Lista e lektorëve të huaj.</i> <i>Aneksi Nr.27, Lista e shkëmbimeve të studentëve në kuadër të Programit ERASMUS.</i> <i>Aneksi Nr.55, Lista e shkëmbimeve të stafit në kuadër të Programit ERASMUS.</i></p>			
<b>Kriteri 6.</b> Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit	<p>Për cdo periudhë 1 vjecare, institucioni në nivel fakulteti, harton raporte analitike të të dhënve që lidhen me këtë program studimi të tilla si: angazhimin dhe ngarkesa e stafit akademik, numri I studentëve të rregjistruar dhe të diplomuar, marrëveshjet e bashkëpunimit në kuadër të projekteve dhe programeve të mobiliteti Erasmus etj.</p> <p><i>Aneksi Nr.29, Raport vjetor i aktiviteti mësimor, kërkimor dhe shkencor- FE Viti 2021-2022.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi I.6</b>	
<b>Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për	Plani strategjik i kërkimit shkencor të UMT-së shërben si një udhëzues ndër të tjera edhe për kërkimin shkencor. Stafi akademik merr pjesë

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 16



<p>publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>vazhdimisht në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare si edhe publikon punimet e tyre në revista ndërombëtare.</p> <p>UMT dhe FE organizojnë konferenca vjetore si një mënyrë për të transferuar dhe shpërndarë rezultatet e kërkimit shkencor. Punimet shkencore ndër të tjera publikohen në revistën shkencore “Metropolitan Tirana Journal of Business and Economics”si edhe në revistën “Metropolitan Tirana Journal of Science, Engineering and Architecture (MTJSEA)” në formë online dhe të printuar.</p> <p><a href="https://umt.edu.al/revista-kerkimore/">https://umt.edu.al/revista-kerkimore/</a></p> <p>Pjesëmarrja në projekte të ndryshme gjithashtu është një mënyrë për të mbështetur stafin në realizmin e kërkimit shkencor në bashkëpunim me kërkues të huaj.</p> <p><i>Aneksi Nr.06, Plani strategjik i zhvillimit të UMT.</i>  <i>Aneksi Nr.30, Lista e projekteve te aplikuara dhe të fituara nga UMT.</i>  <i>Aneksi Nr.33, Raporti mbi aktivitetin kërkimor-shkencor të stafit akademik të FE.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Rezultatet e punës kërkimore analizohen në nivel departamenti dhe njësie kryesore për periudhë një vjeçare. Puna kërkimore konsiderohet si pjesë e ngarkesës akademike të detyrueshme dhe në manualin e vlerësimit të performancës, kontributi në kërkimin shkencor dhe krijimtarinë artistike përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1)kërkim dhe veprimtari krijuese,</li> <li>2)pjesëmarrje në programe kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare,</li> <li>3)konferenca, seminare, kongrese,</li> <li>4)workshope,</li> <li>5)krijimtari artistike etj,</li> <li>6)publikim monografish,</li> <li>7)artikujsh e punimesh shkencore të natyrave të ndryshme në periodikë apo serial botimesh shkencore jo periodikë me komitet shkencor vlerësuese drejtues, pjesëmarrje në borde revistash, udhëheqje programesh doktorale etj.</li> </ol> <p><i>Aneksi Nr.33, Raporti mbi aktivitetin kërkimor-shkencor të stafit akademik të FE.</i>  <i>Dokumentacion shtesë Arkivi-Riorganizimi i aktivitetit te kerkimit shkencor R&amp;D.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Institucioni organizon konferenca vjetore si një mënyrë për promovimin e kërkimit shkencor ndër të thera edhe të stafit akademik të UMT. Punimet shkencore ndër të tjera publikohen në revistën shkencore “Metropolitan Tirana Journal of Business and Economics”si edhe në revistën “Metropolitan Tirana Journal of</p>

	Science, Engineering and Architecture (MTJSEA)” në formë online dhe të printuar.  <a href="https://umt.edu.al/revista-kerkimore/">https://umt.edu.al/revista-kerkimore/</a>								
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese.	Sikurse përmendet edhe ne Statutin e UMT, Neni 88 dhe 89, veprimtaritë kërkimore duhet të integrohen me mësimin. Institucioni, i kushton një rëndësi të vecantë integritetit të kërkimit shkencor duke u bazuar në Rregulloren e Këshillit të Etikës (Neni 6).  <i>Aneksi Nr.05, Statuti i UMT.</i> <i>Aneksi Nr.36, Rregullore e Këshillit të Etikës.</i>								
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor	Në lidhje me këtë aspekt, bazuar edhe tek takimi që GVJ pati me studentët dhe stafin akademik të këtij programi studimi, <i>GVJ mendon që më shumë mund të bëhet për inkurajimin dhe përfshirjen e studentëve në kërkim shkencor bashkë me pedagogët, pasi në dokumentacionin e vënë në dispozicion por edhe në takimin me studentët e këtij programi studimi nuk u evidentua ndonjë ekperiencë e tillë.</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe	Programi i studimit Master Shkencor “Menaxhim në Inxhinieri” është program i ciklit të dytë i organizuar në module/lëndë të cilat kanë kreditet përkatëse ECTS, në përfundim të të cilit lëshohet diploma master i shkencave. Sikurse është përmendur edhe më sipër, programi ka 120 ECTS, zhvillohet në dy vite akademike të ndarë në 4 semestra dhe zbaton përcaktimet e ligjit 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 18

<p>Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>e Shqipërisë” me nenet përkatëse si dhe VKM nr 41. Ndarja në kategoritë përkatëse, ndarjet e orëve për çdo lëndë me kreditet përkatëse për çdo semestër, përcaktohen në rregulloren e programit dhe planin mësimor të tij duke reflektuar kërkesat e akteve nënligjore në fuqi të miratuara nga MASR.</p> <p><i>Aneksi Nr.05, Statuti i UMT.</i>  <i>Aneksi Nr.09, Rregullore e programit të studimit në “MSc” në Menaxhim në Inxhinieri.</i>  <i>Aneksi Nr.16, Plani mësimor i programit studimor MSc në MI.</i>  <i>Aneksi Nr.38, Plani mësimor sipas llojit të veprimtarisë A-E.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Programi synon formimin shkencor të profileve bashkëkohore të profesionistëve dhe studjuesve të rinj, në fushën e menaxhimit të projekteve dhe në teknikat e përdorura për zhvillimin efikas të tyre duke ndërthurur njohuritë me aplikimin e tyre.</p> <p>Nëpërmjet programit të studimit Master Shkencor në Menaxhim në Inxhinieri, studentët thellojnë njohuritë në drejtim të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ekonomiks manaxherial</li> <li>• Tregu dhe instrumentat financiare</li> <li>• Menaxhim projektesh</li> <li>• Projektim dhe menaxhim i sistemeve të qëndrueshme</li> <li>• Menaxhim i burimeve njerëzore</li> <li>• Trajtimi i të dhënave dhe vendimmarrja</li> <li>• Programim dhe menaxhim i kantierëve</li> <li>• Sistemet e menaxhimit të informacionit</li> <li>• Strategji marketingu</li> <li>• Siguria e sistemeve të informacionit</li> </ul> <p>Në përfundim të këtij programi studimi, i diplomuari është në gjendje të analizojë probleme e të japë zgjidhje përmes një tërësie instrumentesh si edhe të përfshihet në vendimmarrje manaxheriale.</p> <p><i>Aneksi Nr.09, Rregullore e programit të studimit në “MSc” në Menaxhim në Inxhinieri.</i>  <i>Aneksi Nr.16, Plani mësimor i programit studimor MSc në MI.</i>  <i>Aneksi Nr.38, Plani mësimor sipas llojit të veprimtarisë A-E.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Lëndët dhe veprimtaritë mësimore të programit lidhen harmonikisht me objektivat formues të programit të studimit.</p> <p>Programi i studimit synon të:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a. Pajisë të diplomuarit me njohuri të thelluara për vendimmarrje manaxheriale dhe aftësi manaxheriale në këtë drejtim</li> </ol>

	<p>b. Aftësojë studentët të formojnë pikëpamjet e tyre dhe të gjenerojnë analiza për menaxhimin eficient të aktiviteteve në fushën e inxhinierisë</p> <p>c. Mundësojë karrierë të suksesshme dhe kualifikim të mëtejshëm në varësi me ndryshimet e kushteve të tregut të punës.</p> <p>Në tërësi lëndët dhe syllabuset reflektojnë mire këto objektiva në leksionet dhe materialet që japin për studentët, detyrat përkatëse si dhe aktivitetet në klasë. Po kështu literatura në pjesën më të madhe është e pesë viteve të fundit duke mundësuar përditësimin e koncepteve në mënyrë të vazhdueshme.</p> <p><i>Aneksi Nr.09, Rregullore e programit të studimit në "MSc" në Menaxhim në Inxhinieri.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.10, Dosja e programit MSc në MI.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.16, Plani mësimor i programit studimor MSc në MI.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.18, Plan programet e lëndëvesyllabuset</i></p> <p><i>Aneksi Nr.39, Plani mësimor 2022-2023 për programin Msc në Menaxhim ne Inxhinieri.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Siç u shprehëm edhe më sipër, programi i studimit i ofron studentëve njohuritë e nevojshme për të përvetësuar kompetenca teorike dhe praktike. Në tërësi, në këtë program studimi studentit i mundësohet përvetësimi i njohurive të thelluara dhe aftësimi profesional me qëllim përshtatjen, sa më shumë të jetë e mundur, nevojave të tregut të punës si dhe zhvillimeve të vendit por edhe më gjerë.</p> <p><i>Aneksi Nr.09, Rregullore e programit të studimit në "MSc" në Menaxhim në Inxhinieri.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.10, Dosja e programit MSc në MI.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.16, Plani mësimor i programit studimor MSc në MI.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.18, Plan programet e lëndëvesyllabuset</i></p> <p><i>Aneksi Nr.39, Plani mësimor 2022-2023 për programin Msc në Menaxhim ne Inxhinieri.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Programi i studimit është pjesë e ciklit të dytë të studimeve dhe përmban elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit në përputhje me kriteret e vendosura në VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018.</p> <p><i>Aneksi Nr.09, Rregullore e programit të studimit në "MSc" në Menaxhim në Inxhinieri.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.16, Plani mësimor i programit studimor MSc në MI.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.18, Plan programet e lëndëvesyllabuset</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" ka të përcaktuar qartë</p>	<p>Ky program organizohet në module/lëndë me kredite ECTS dhe lëndët grupohen sipas VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018 si vijon:</p>

<p>veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p><b>A.</b> Lëndë bazë që përcaktojnë formimin e përgjithshëm, përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithshme – <b>2 lëndë</b>, 12 kredite ECTS (10 % e totalit të krediteve);</p> <p><b>B.</b> Lëndë karakterizuese, që lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe japin një formim specifik – <b>10 lëndë</b>, 60 kredite ECTS (50 % e totalit të krediteve);</p> <p><b>C.</b> Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese në një ose më shumë grupe disiplinash, të ngjashme dhe/ose integruese me disiplinat karakterizuese, profile të programit dhe grup-lëndë me zgjedhje – <b>3 lëndë</b> me zgjedhje, 18 kredite ECTS (15 % e totalit të krediteve);</p> <p><b>D.</b> Lëndë plotësuese - praktikat profesionale – 12 kredite ECTS (10 % e totalit të krediteve të këtij programi);</p> <p><b>E.</b> Detyrime përmbyllëse, që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës – 18 kredite ECTS (15 % e totalit të krediteve).</p> <p><i>Aneksi Nr.09, Rregullore e programit të studimit në “MSc” në Menaxhim në Inxhinieri.</i>  <i>Aneksi Nr.16, Plani mësimor i programit studimor MSc në MI.</i>  <i>Aneksi Nr.38, Plani mësimor sipas llojit të veprimtarisë A-E.</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Programi i studimit ka të përcaktuar kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj</p>	<p>Programi i studimit ka 120 kredite ECTS dhe kohëzgjatje 2 vite akademike sipas detyrimeve ligjore. Në këtë program detyrimet përmbyllëse, që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës, kanë 18 kredite ECTS ose 15 % e krediteve. Teza e diplomës është punë e pavarur në formën e një studimi analitik që lidhet me formimin e marrë gjatë programit. Në përfundim të diplomimit, studenti pajiset me diplomën përkatëse Master i Shkencave e cila firmoset nga dekani i FE dhe Rektori i UMT. Nga takimi me studentët që ndjekin këtë program studimi u informuan për procedurën e caktimit të temës me pedagogun udhëheqës. Ky i fundit paraqet një listë me tema të mundshme dhe pasi studenti zgjedh. Pedagogu i dërgon strukturën e punimit. Nga vlerësimi i dosjes së dokumentacionit të paraqitur nga IAL, vihet re që studentëve iu mundësohet një udhëzues për përgatitjen e mikrotezes dhe elementëve përbërës të saj si dhe formati që duhet të ndjekë studenti në punimin e saj.</p> <p><i>Aneksi Nr.07, Rregullore e UMT.</i>  <i>Aneksi Nr.09, Rregullore e programit të studimit në “MSc” në Menaxhim në Inxhinieri.</i>  <i>Aneksi Nr.40. Procedurat e përgatitjes dhe mbrojtjes së diplomës-MSc-MI.</i>  <i>Aneksi Nr.41, Modeli i diplomës-Msc në Menaxhim ne Inxhinieri.</i></p>

	<i>Aneksi Nr.42, Suplement diplome-Msc në Menaxhim ne Inxhinieri.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

<b>Standardi II.2</b>	
<b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>GVJ, bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni, evidenton që njësia kryesore FE dhe njësia bazë Departamenti i Informatikës Ekonomike, për programin e studimit MSc Menaxhim në Inxhinieri përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p> <p>Organizimi i njësisë kryesore bazohet në legjislacionin për arsimin e lartë në fuqi, statutin e UMT-së dhe aktet e tjera nën-ligjore. Aktualisht njësia kryesore, FE, përgjegjëse për programin e studimit Msc Menaxhim në Inxhinieri përbëhet nga 3 departamente:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Departamenti i Shkencave të Administrimit</li> <li>• Departamenti i Financë Bankë</li> <li>• Departamenti i Informatikës Ekonomike</li> </ul> <p>Departamenti i Informatikës Ekonomike që është përgjegjës për programin e studimit Msc Menaxhim në Inxhinieri, plotëson detyrimet ligjore për raportin e stafit PAE/ PAK. Në total raporti i orëve që mbulojnë pedagogë PAE për vitin 2022-2023 (sipas parashikimit dhe ndarjes së ngarkesës mësimore) është rreth 71% të ngarkesës totale të orëve të zhvilluara për këtë program studimi. Stafi akademik PAK mbulon rreth 29% të ngarkesës totale.</p> <p><i>Aneksi Nr.05, Statuti i UMT.</i>  <i>Aneksi Nr.24, Organigrama e UMT.</i>  <i>Tabelat Shqip, tabela 12.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në program përbëhet nga personel akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme me tituj akademik e grada shkencore. GVJ vëren se stafi akademik i përfshirë në realizimin e programit është me formimin e duhur, me grada e tituj dhe – bazuar në takimin me studentët – profesional e i disponueshëm.</p> <p>Kështu për vitin akademik 2022-2023 Departamenti i Informatikës Ekonomike ka:</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 22

	<p>8 PAE nga të cilët 3 mbajnë titullinë Profesor/Prof i Asociuar, 3 mbajnë titullin Dr dhe 1 kandidat për Dr dhe 1 MsC, pra 75% e stafit është me tituj dhe grada.</p> <p>6 PAK nga të cilët vetëm 4 janë me tituj e grada. Për vitin 2022-2023 stafi PAK mbulon 29% të ngarkesës me orë në programin e studimit, duke qënë në përputhje të plotë me rregullin 70/30.</p> <p><i>Aneksi Nr.05, Statuti i UMT.</i>  <i>Aneksi Nr.15, Lista e personelit akademik me kohe të plotë dhe me kohë të pjesshme në FE.</i>  <i>Aneksi Nr.22, Të dhëna statistikore të personelit akademik PAEPAK TabNr 1.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<p>Siç u përmend edhe më sipër, bazuar në tabelat përmbledhëse të dorëzuara nga IAL, janë të angazhuar 7 PAE dhe 100% e stafit akademik PAE e angazhuar në programin e studimit Master Shkencor Menaxhim në Inxhinieri për vitin akademik 2022-2023 është me tituj e grada.</p> <p>Në vitin akademik <b>2022-2023</b> departamenti ka angazhuar në total 7 PAE/ 9 PAK dhe 100% e personelit PAE dhe PAK janë me tituj dhe grada.</p> <p>Në vitin akademik <b>2021-2022</b> , 8 PAE/ 7 PAK edhe në këtë vit 100% e stafit PAE dhe PAK është me tituj dhe grada.</p> <p>Në vitin akademik <b>2020-2021</b> , 8 PAE/ 9 PAK edhe në këtë vit 88% e stafit PAE dhe 89% e PAK është me tituj dhe grada.</p> <p>Në tërësi, GVJ vëren se Departamenti i Informatikës Ekonomike ka angazhuar burime njerëzore të kualifikuara në përputhje me profilin dhe kërkesat e programit të studimit.</p> <p><i>Tabelat Shqip, tabela 6, 6.1, 6.2.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>FE si dhe njësitë bazë përbërëse të tij janë në përputhje me Statutin e UMT i cili është miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin. Sikurse u përmend edhe më sipër FE përbëhet nga 3 njësi bazë .</p> <p><i>Aneksi Nr.05, Statuti i UMT.</i>  <i>Aneksi Nr.24, Organigrama e UMT.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.</p>	<p>Në përbërje të programit të studimit, sikurse u përmend edhe më sipër një peshë të rëndësishme në numrin e krediteve zë praktika profesionale, me 12 ECTS. Departamenti i Informatikës Ekonomike ka përcaktuar për secilin student një mbikqyrës praktike brenda departamentit. Gjithashtu, studenti ka edhe një mbikqyrës praktike në institucionin ky kryen praktikën. Gjithashtu edhe për punimin e diplomës, studenti ka pedagogun udhëheqës i cili e udhëzon dhe e ndjek gjatë gjithë ecurisë së punimit të diplomës.</p>

	<p><i>Aneksi Nr.17, Dokumentacioni i praktikës për programin e studimit.</i>  <i>Aneksi Nr.40. Procedurat e përgatitjes dhe mbrojtjes së diplomës-MSc-MI.</i>  <i>Aneksi Nr.73, Plan pune për punimin e diplomës-Msc ne Menaxhim ne Inxhinieri.</i></p>		
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Për programin e studimit është miratuar koordinatori i programit. Në rregulloren e programit të studimit, në nenin 12 përcaktohen detyrat e tij të cilat lidhen me organizimin dhe koordinimin e aktiviteteve për mbarëvajtjen e programit të studimit. GVJ e vlerëson këtë si një praktikë pozitive për cilësinë e programit të studimit.</p> <p><i>Aneksi Nr.09, Rregullore e programit të studimit në "MSc" në Menaxhim në Inxhinieri.</i>  <i>Aneksi Nr.43, Lista e përgjegjesave të programeve studimore.</i></p>		
<p><b>Kriteri 7.</b> Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit</p>	<p>Koordinatori i programit të studimit ka detyrat e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Bashkëpunon dhe koordinon aktivitetet me strukturat përgjegjëse për zhvillimin e programit të studimit në përputhje me Statutin, rregulloren e UMT dhe të Departamentit përgjegjës për programin e studimit,</li> <li>• Shqyrton cdo kërkesë të studentit e cila depozitohet paraprakisht në sekretarinë mësimore.</li> <li>• Raporton për përmbushjen dhe respektimin e standarteve të cilësisë për ecurinë e programit të studimit</li> <li>• Të realizojë funksionimin dhe kordinimin e procesit mësimor por edhe atë kërkimor shkencor që lidhet me programin e studimit.</li> </ul> <p><i>Aneksi Nr.09, Rregullore e programit të studimit në "MSc" në Menaxhim në Inxhinieri, neni 12.</i></p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi II.3</b>	
<b>Programi i studimit MSH/MA është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e</p>	<p>FE është njësia kryesore pranë UMT, përgjegjëse për programe studimit. Duke analizuar dokumentacionin e dërguar, bazuar edhe në vizitën në institucion, GVJ vëren se Departamenti I Informatikës Ekonomike ka informacionet në lidhje me organizimin, strukturën dhe</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 24



<p>nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>përmbajtjen e programit. Siç jemi shprehur edhe më sipër, programi i studimit, bazuar në VKM nr. 41, datë 24.01.2018, i ndryshuar ka:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a) kreditet ECTS;</li> <li>b) kontrollin e dijeve dhe instrumentet e vlerësimit;</li> <li>c) objektivat formues dhe kompetencat profesionale;</li> <li>ç) veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit;</li> <li>d) kategoritë e veprimtarive formuese, që karakterizojnë një program studimi;</li> <li>dh) planin mësimor;</li> <li>e) kuotat e pranimit;</li> <li>ë) programin lëndor;</li> <li>f) profilin e programit;</li> <li>g) diplomën dhe suplementin</li> </ul> <p>Për gjithë sa më sipër, GVJ bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Institucioni sikurse edhe nga vizita në institucion, evidenton plotësimin e këtij kriteri.</p> <p><i>Aneksi Nr.09, Rregullore e programit të studimit në "MSc" në Menaxhim në Inxhinieri.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.10, Dosja e programit MSc në MI.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.18, Plan programet e lëndëvesyllabuset.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Sikurse edhe më sipër, programi i studimit i përket ciklit të dytë dhe organizohet në lëndë me ECTS. Veprimtaria mësimore realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike: leksione; seminare; detyrash apo projektesh; prezantime, provime; përgatitje për provime; përgatitje e tezës së diplomës; praktika profesionale.</p> <p><i>Aneksi Nr.09, Rregullore e programit të studimit në "MSc" në Menaxhim në Inxhinieri.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.10, Dosja e programit MSc në MI.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.16, Plani mësimor i programit studimor MSc në MI.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.18, Plan programet e lëndëvesyllabuset.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Sikurse analizuar edhe më sipër ndarja e orëve mësimore në auditor në leksione e seminare përcaktohet në planin mësimor të programit të studimit në bazë të krediteve sipas kriterëve të specifikuar në aktet nën ligjore. Në vitin e parë studentët zhvillojnë në auditor 600 orë (60 ECTS), ndërsa në vitin e dytë, 600 orë në total (60 ECTS).</p>

	<p>Në përfundim të studimeve studenti grumbullon 120 ECTS. Viti akademik zhvillohet në dy semestra me kohëzgjatje 15 javë çdo semestër.</p> <p><i>Aneksi Nr.09, Rregullore e programit të studimit në "MSc" në Menaxhim në Inxhinieri.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.10, Dosja e programit MSc në MI.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.16, Plani mësimor i programit studimor MSc në MI.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.18, Plan programet e lëndëvesyllabuset.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Sikurse është analizuar më sipër, plani mësimor zbaton kriteret e vendosura në VKM nr. 41, datë 24.01.2018. Në planin mësimor detajohen lëndët - të ndara sipas kategorive formuese si dhe në vite e semestra - dhe kreditet përkatëse. Plani detajon gjithashtu ngarkesën mësimore, orët në dhe jashtë auditorit, frekuentimin e lëndëve dhe vlerësimin e dijeve.</p> <p><i>Aneksi Nr.09, Rregullore e programit të studimit në "MSc" në Menaxhim në Inxhinieri.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.10, Dosja e programit MSc në MI.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.16, Plani mësimor i programit studimor MSc në MI.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.18, Plan programet e lëndëvesyllabuset.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Ky program ka detajuar në rregulloren e tij - bazuar në kriteret ligjore - dhe i ka publike, elementet që kanë të bëjnë me kriteret e pranimit dhe transferimit. Kuotat dhe kriteret e veçanta për pranimin e studentëve në programin e studimit Master Shkencor në Menaxhim në Inxhinieri, bëhen me vendim të Senatit Akademik, mbështetur në propozimet e Departamentit të Informatikës Ekonomike, miratimin e FE-së, në përputhje me kuotat e akorduara nga ministria e arsimit. Në nenin 16, 17 dhe 18 të rregullores së programit të studimit paraqiten në formë të detajuar kushtet dhe procedurat e pranimit të studentëve në këtë program studimi si edhe dokumentacioni përkatë pranues. Gjithashtu në rregulloren e programit të studimit, neni 21 janë përcaktuar rregullat për transferimin e studimeve.</p> <p><i>Aneksi Nr.09, Rregullore e programit të studimit në "MSc" në Menaxhim në Inxhinieri.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.10, Dosja e programit MSc në MI.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.44, Kriteret e pranimit në programet studimore të FE.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.45, Procedure aplikimi, regjistrimi dhe transferimi.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.87, Raport i MASR mbi certifikimin e kuotave të pranimit në UMT.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet</p>	<p>Bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit dhe vizitën në IAL, programi ka syllabuset për secilën lëndë, për praktikatat, dhe seminarat. Për syllabuset dhe praktikatat respektohen formatet e miratuara për këtë</p>

<p>lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>qëllim në VKM nr. 41 datë 24.01.2018. Për mikrotezën dhe praktikën, janë miratuar formatet dhe udhëzime specifike.</p> <p><i>Aneksi Nr.09, Rregullore e programit të studimit në "MSc" në Menaxhim në Inxhinieri.</i>  <i>Aneksi Nr.10, Dosja e programit MSc në MI.</i>  <i>Aneksi Nr.16, Plani mësimor i programit studimor MSc në MI</i>  <i>Aneksi Nr.17, Dokumentacioni i praktikës për programin e studimit.</i>  <i>Aneksi Nr.18, Plan programet e lëndëvesyllabuset.</i>  <i>Aneksi Nr.40. Procedurat e përgatitjes dhe mbrojtjes së diplomës-MSc-MI.</i>  <i>Aneksi Nr.73, Plan pune për punimin e diplomës-Msc ne Menaxhim ne Inxhinieri.</i></p>		
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht</p>	<p>Institucionit i lejohej që deri në masën 20 % të përmbajtjes së programit, të shprehur në kredite ECTS, me miratim të Senatit të ndërmarrë ndryshime. Për këtë program studimi nuk ka patur ndryshime rrenjësores me përjashtim të 2 lëndëve: Siguria e sistemeve të Informacionit dhe Trajtimi i të dhënave dhe Vendimmarrja.</p> <p><i>Aneksi Nr.09, Rregullore e programit të studimit në "MSc" në Menaxhim në Inxhinieri.</i>  <i>Aneksi Nr.50, Praktika e miratimit dhe përmirësimit të kurrikulës së programit të një programi.</i></p> <p><i>001-RVB_Shqip.</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi II.4</b>  <b>Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p> <p><b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit "Master i Shkencave"/"Master i Arteve" është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p> <p>Sikurse e kemi përmendur më sipër, programi është organizuar në leksione, seminare dhe praktika profesionale me kredite ECTS bazuar në VKM 41 datë 24.1.2018.</p> <p>Në tërësi, GVJ vëren se organizmi dhe zhvillimi i programit dhe shpërndarja e ngarkesës mësimore ETCS i mundëson studentëve arritjen e objektivave të programit dhe përfundimin aftësive profesionale.</p>

	<p><i>Aneksi Nr.09, Rregullore e programit të studimit në “MSc” në Menaxhim në Inxhinieri.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.10, Dosja e programit MSc në MI.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.16, Plani mësimor i programit studimor MSc në MI</i></p> <p><i>Aneksi Nr.18, Plan programet e lëndëvesyllabuset.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>GVJ vëren se emërtimi i programit është i përshtatshëm me përmbajtjen dhe shpërndarja e lëndëve dhe praktika mundëson përmbushjen e objektivave të programit dhe aftësimin e studentëve në studimet evropiane. Siç kemi thënë edhe më sipër lëndët e programit dhe sylabuset janë të krahasueshme me programe të ngjashme në BE dhe i ofrojnë studentëve mundësinë të fitojnë aftësi dhe profesionalizëm.</p> <p><i>Aneksi Nr.10, Dosja e programit MSc në MI.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.16, Plani mësimor i programit studimor MSc në MI</i></p> <p><i>Aneksi Nr.18, Plan programet e lëndëvesyllabuset.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënimit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>GVJ vëren, siç ka vërejtur edhe më sipër, që lëndët dhe shpërndarja e tyre i mundësojnë studentëve pajisjen dhe zbatimin në praktikë të aftësive metodologjike dhe njohurive teorike të cilat përdoren në projektet, detyrat e kursit si dhe në punimin e mikrotezes. Të gjitha këto lehtësojnë dhe mundësojnë integrimin e të diplomuarve në tregun e punës.</p> <p><i>Aneksi Nr.09, Rregullore e programit të studimit në “MSc” në Menaxhim në Inxhinieri.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.10, Dosja e programit MSc në MI.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.16, Plani mësimor i programit studimor MSc në MI</i></p> <p><i>Aneksi Nr.18, Plan programet e lëndëvesyllabuset.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>GVJ vëren se programi i studimit, në strukturë dhe përmbajtje, është i krahasueshëm me programe të ngjashme ndërkombëtare. Konsultimi i vazhdueshëm i programeve të ngjashme brenda dhe jashtë vendit i shërben IAL-së për të ndërtuar një program studimi kompetitiv dhe me impakt në tregun e punës.</p> <p><i>Aneksi Nr.10, Dosja e programit MSc në MI.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.16, Plani mësimor i programit studimor MSc në MI</i></p> <p><i>Aneksi Nr.18, Plan programet e lëndëvesyllabuset.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Nga vizita në institucion, takimi me pedagogët dhe studentët, GVJ evidentoi se në leksione sikurse edhe në seminare tentohet vazhdimisht gërshtimi i teorisë me situata praktike. Duke patur parasysh edhe faktin që një pjesë e studentëve kur regjistrohen janë të punësuar apo punësohen gjatë periudhës së studimeve, kjo krijon mundësi edhe për diskutime dhe detyra të nivelit me praktik.</p> <p><i>Aneksi Nr.10, Dosja e programit MSc në MI.</i></p>

	<i>Aneksi Nr.16, Plani mësimor i programit studimor MSc në MI</i> <i>Aneksi Nr.18, Plan programet e lëndëvesyllabuset.</i>
<b>Kriteri 6.</b> Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	Çdo lëndë ka syllabusin në gjuhën shqipe dhe angleze. Nga takimi me pedagogët e angazhuar në programin e studimit, GVJ vëren se stafi bëjnë përpjekje për të pasuruar literaturën në syllabuset e lëndëve.  <i>Aneksi Nr.16, Plani mësimor i programit studimor MSc në MI</i> <i>Aneksi Nr.18, Plan programet e lëndëvesyllabuset.</i>
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë.	Nga analiza sidomos e syllabuseve, GVJ vëren se ka përputhje midis titullit të lëndës, objektivave, literaturës dhe instrumentave të vlerësimit. Të gjitha këto mundësojnë përfitimin e dijeve të një programi të ciklit të dytë.  <i>Aneksi Nr.16, Plani mësimor i programit studimor MSc në MI</i> <i>Aneksi Nr.18, Plan programet e lëndëvesyllabuset.</i>
<b>Kriteri 8.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimitin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Sikurse e kemi përmendur më sipër, programi është organizuar në leksione, seminare dhe praktika profesionale me kredite ECTS bazuar në VKM 41 datë 24.1.2018. Sipas ligjit të arsimit të lartë, diplomimi nga një program MSh i jep mundësinë studentit, nëse plotëson kriteret e tjera, të vijojë studimet e ciklit të tretë. Ky program studimi duke patur si një detyrim edhe shkrimin e temës së diplomës, i përgatit studentët për jetën kërkimore që duhet të ndërmarrin si doktorantë. Përsa i përket tregut të punës, studentët mund të punësohen në sektorin privat por nuk përjashtohet edhe sektori publik.  <i>Aneksi Nr.16, Plani mësimor i programit studimor MSc në MI</i> <i>Aneksi Nr.18, Plan programet e lëndëvesyllabuset.</i>
<b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	UMT ka një sërë bashkëpunimesh me partnerë, të sektorit publik dhe privat. Nga bashkëpunimi me to, mbledh informacion mbi përshtatshmërinë e programit dhe nevojave të tregut të punës. Bazuar edhe tek RVB, bazuar tek kërkesat e tregut të punës për këtë program studimi ka patur ndryshime edhe pse jo rrenjësores duke përfshirë lëndët: Siguria e sistemeve të Informacionit dhe Trajtimi i të dhënave dhe Vendimmarrja.  <i>Aneksi Nr.28, Lista e marreveshjeve për zhvillimin e praktikave.</i>
<b>Kriteri 10.</b> Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të	GVJ sikurse ka sygjerruar, programi i studimit duhet të ofrojë trajnim të avancuar në metoda kërkimi duke e përfshirë në planin mësimor. Kjo duke patur gjithashtu edhe si një detyrim shkrimin e temës së diplomës, i përgatit studentët për jetën kërkimore që duhet të ndërmarrin si doktorantë.

aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve	Aneksi Nr.16, Plani mësimor i programit studimor MSc në MI Aneksi Nr.18, Plan programet e lëndëvesyllabuset.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			X	

### Standardi II.5

**Personeli akademik dhe ndihmësakademik që mbulon programin e studimit përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																				
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka kualifikimin me tituj akademikë e grada shkencore duke përmbushur kërkesat ligjore dhe pritshmëritë e cilësisë akademike. Po aq e rëndësishme, stafi akademik në këtë program studimi angazhohet në proceset e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë dhe gjithë elementëve e tjerë të programit të studimit.</p> <p>Referuar të dhënave rezultojn se ngarkesa mësimore mbulohe nga stafi akademik PAE mbi masën 71% dhe 29% nga PAK në të tre vitet që ne disponojmë të dhënat.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, takimi me personelin si dhe takimi me studentët, GVJ vëren se kriteri 2 plotësohet.</p> <p>Personeli akademik i angazhuar në këtë program ka kualifikime brenda dhe jashtë vendit, me tituj dhe grada shkencore, dhe të gjithë janë me eksperiencë në fushën e mësimdhënies dhe në kërkim shkencor.</p> <p>GVJ vëren se mbulimi i ngarkesës mësimore dhe norma përkatëse respekton raportin PAE/PAK bazuar në Udhëzimin nr. 29, datë 10/09/2018 të MASR (sqaruar më sipër).</p> <p>Bazuar në të dhënat tabelore të dërguar nga IAL rezultojn se stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi ka pasur kualifikimin si më poshtë:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Personeli i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit</th> <th colspan="2">Viti akademik 2022-2023</th> <th colspan="2">Viti akademik 2021-2022</th> <th colspan="2">Viti akademik 2020-2021</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Personeli i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit	Viti akademik 2022-2023		Viti akademik 2021-2022		Viti akademik 2020-2021		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK							
Personeli i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit	Viti akademik 2022-2023		Viti akademik 2021-2022		Viti akademik 2020-2021																
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK															

	Prof Dr	-	3	-	2	1	2
	Prof.Assoc	1	2	1	1	1	1
	Dr/Doc	6	4	7	4	5	5
	Msc (Dr në proces)	-	-	-	-	1	-
	Msc	-	-	-	-	-	1
	<b>Në total</b>	<b>7</b>	<b>9</b>	<b>8</b>	<b>7</b>	<b>8</b>	<b>9</b>
	<p>Në këtë program studimi angazhohen staf i kualifikuar me tituj dhe grada në përputhje me kriteret ligjore.</p> <p><i>Tabelat Shqip, tabela 4; 6; 6.1; 6.2</i></p>						
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>GVJ vëren se, fushat akademike të përgjithshme dhe specifike të stafit akademik kanë përputhje si me programin e studimit ashtu edhe me lëndët specifike që ato mbulojnë. Siç u shprehëm më sipër, eksperiencia akademike ndërthuret mirë edhe me atë profesionale duke e shtuar gamën e informacionit që ofrohet për studentin.</p> <p><i>Aneksi Nr.16, Plani mësimor i programit studimor MSc në MI</i>  <i>Aneksi Nr.18, Plan programet e lëndëvesyllabuset.</i>  <i>Aneksi Nr.54, CV e stafit akademik të programit.</i></p>						
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Si u përmend edhe më sipër, GVJ vëren se departamenti ka angazhuar pedagogë të posaçëm për mbikëqyrjen e praktikës e cila zhvillohet në institucione apo subjekte me të cilat UMT ka marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p>E njehta praktikë ndiqet edhe për udhëheqjen e diplomës për të cilën angazhohet staf akademik me tituj dhe grada pedagog PAE të FE dhe Departamentit të Informatikës Ekonomike. Në këtë kuadër puna e studentëve drejtohet edhe nga Udhëzuesi për përgatitjen dhe mbrojtjen e mikrotezës (referuar më sipër).</p> <p><i>Aneksi Nr.17, Dokumentacioni i praktikës për programin e studimit.</i>  <i>Aneksi Nr.56, Lista e temave për mbojtje diplome.</i>  <i>Tabelat Shqip, tabela 4;</i></p>						
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësimorshkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas</p>	<p>GVJ vëren se ky program studimi nuk ka orë laboratorike e laboratorë të dedikuar dhe kjo duke ju referuar planit mësimor (Tabela 13). <i>Gjithsesi, GVJ duke parë me kujdes planin mësimor dhe tipologjitë e lëndëve, sygjeron që një pjesë të lëndëve sygjeron përfshirjen e orëve laboratorike në shpërndarjen e krediteve dhe orëve mësimore. Psh në</i></p>						

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 31

natyrës specifike të programit të studimit	lëndë të tilla si: <i>Sistemet e Informacionit të Menaxhimit apo Siguria e Sistemeve të Informacionit.</i>  <i>Tabelat Shqip, tabela 13.</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi II.6</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	GVJ është shprehur edhe më sipër përsa i përket anagazhimit me tregun e punës. Në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni, ndër të tjera paraqitet edhe analiza e tregut të punës për këtë program studimi. UMT ka një sërë bashkëpunimesh me partnerë, të sektorit publik dhe privat. Nga bashkëpunimi me to, mbledh informacion mbi përshtatshmërinë e programit dhe nevojave të tregut të punës.  Gjatë vizitës që GVJ pati në institucion në takimin me studentët e këtij programi studimi, prej tyre na u konfirmua që ata ishin të punësuar dhe një pjesë e tyre ishin të punësuar kur janë regjistruar janë. Kjo është një pikë shumë e fortë e programit.  <i>Aneksi Nr.12, Studim tregu për programin e studimit në "MSc në MI.</i> <i>Aneksi Nr.28, Lista e marreveshjeve për zhvillimin e praktikave.</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimin të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen, nëse ato janë në funksion të përmirësimin të programit të studimit.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni si edhe nga nga takimi me studentët u informuam se ato kishin një sërë instrumentash në dispozicion, formalë dhe informalë, për të dhënë mendimin e tyre për programin e studimit, literaturën në dispozicion si dhe qasjen didaktike.  <i>Takimi me studentët</i> <i>Aneksi Nr.48, Model i pyetësorit të studentit per lendenpedagogun.</i> <i>Aneksi Nr.49, Analiza e NJSBC për pyetësorët S1-2021-2022.</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.	Nga takimet në institucion me përgjegjësit e zyrës së karrierës , GVJ u informua se, UMT përpigjet të ruajë kontaktet me studentët e diplomuar dhe kontakton në mënyrë të herëpashershme me ta, për të gjurmuar të diplomuarit si dhe për të ruajtur lidhjet me universitetin. Zyra e këshillimit të karrierës dhe Alumni mban një databazë të marrëveshjeve me biznesin por edhe të Alumnit. Kjo zyrë mban marrëdhënie me të

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 32





	<p>diplomuarit duke i ftuar ata në takime, projekte, vizita studimore dhe leksione të hapura. Po kështu kjo zyrë ofron dhe asistencë për studentët duke i ndihmuar në gjetjen e praktikës, përpilimit të letrës së motivimit, CV etj.</p> <p><i>Takimi me përfaqësues të zyrës së karrierës</i> <i>Aneksi Nr.14, Rrjeti Alumni UMT</i></p>		
<p><b>Kriteri 4.</b> Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua se UMT ka shtuar përpjekjet për të përditësuar dhe përshtatur programet e studimit me kërkesat dhe nevojat e tregut dhe partnerëve të saj kjo edhe falë projekteve në të cilat ka aplikuar dhe në të cilat është partnere,</p> <p><i>Aneksi Nr.30, Lista e projekteve të aplikuara dhe të fituara nga UMT.</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

### Standardi II.7

#### Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhore të institucionit.</p>	<p>GVJ vëren se jo vetëm departamenti dhe fakulteti përgjegjës për këtë program studimi, por edhe vetë UMT e bazon punën kërkimore në Planin strategjik të Zhvillimit të UMT. Programi ka objektiva të qarta që formësojnë dhe reflektohen në planin mësimor dhe syllabuset e lëndëve. Stafi akademik ka arritur të angazhohet në aktivitete shkencore dhe kërkimore të tilla si: konferenca, botime, projekte, ekspertiza etj.</p> <p><i>Aneksi Nr.06, Plani strategjik i zhvillimit të UMT.</i> <i>Aneksi Nr.29, Raport vjetor i aktiviteti mësimor, kërkimor dhe shkencor- FE Viti 2021-2022.</i> <i>Aneksi Nr.33, Raporti mbi aktivitetin kërkimor-shkencor të stafit akademik të FE.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të</p>	<p>GVJ vëren se drejtimet kryesore kërkimore të FE UMT dhe programit të studimit bazohen në <i>Plani strategjik i zhvillimit të UMT</i>. UMT edhe pse nuk ka një buxhet të përcaktuar për mbështetje stafit për prezantime në konferenca apo publikime, ka praktika të mbështetjes së stafit akademik. UMT informon vazhdimisht stafin akademik mbi thirrjet për pjesëmarrje në projekte duke i nxitur të përfshihen në projekte</p>

<p>personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>kërkimore kombëtare e ndërkombëtare, kjo falë asistencës profesionale të Zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë dhe Projekteve.</p> <p><i>Aneksi Nr.06, Plani strategjik i zhvillimit të UMT.</i>  <i>Dokumentacioni shtesë-Personeli-Mbeshtetje financiare staf.</i>  <i>Aneksi Nr.30, Lista e projekteve te aplikuar dhe të fituara nga UMT.</i>  <i>Aneksi Nr.33, Raporti mbi aktivitetin kërkimor-shkencor të stafit akademik të FE.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>GVJ vëren se ky program studimi synon të pajisë të diplomuarit me njohuri teorike e praktike që mundësojnë integrimin në tregun e punës.</p> <p>Studentët e UMT janë gjithashtu të përfshirë në një sërë shkëmbimesh në projekte Erasmus+ në mobilitete të zhvilluara në universite në shtete si: Rumani, Bullgari, Poloni, Letoni, Ceki, Spanjë, Itali, Hungari etj. Për vitin akademik 2021-2022, një studente e këtij programi studimi është përfshirë në programin Erasmus për studim në Universitetin Teknik të Rigës, Letoni.</p> <p><i>Aneksi Nr.27, Lista e shkëmbimeve të studentëve në kuadër të Programit ERASMUS.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.</p>	<p>GVJ, bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Institucioni, takimi me studentët si edhe me stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi, evidenton se thuajse të gjitha lëndët përfshijnë kërkim të pavarur studentor të reflektuar në detyra kursi apo projekte. Gjithashtu studenti në përfundim të studimeve në këtë program studimi duhet të pregatisë dhe punojë temën e diplomës.</p> <p>Gjithashtu, studentët e UMT por edhe të këtij programi studimi, janë përfshirë në punime shkencore, projekte shkencore në rang Fakulteti apo Universiteti sikurse edhe në projekte shkencore në bashkëpunim me të tjerë.</p> <p><i>Aneksi Nr.18, Plan programet e lëndëvesyllabuset.</i>  <i>Tabelat Shqip, tabela 22.Aktivizimi I studentëve në aktivitete të njësisë, tre vitet e fundit.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme</p>	<p>Stafi akademik i UMT janë të përfshirë në një sërë shkëmbimesh në projekte Erasmus+ në mobilitete të zhvilluara në universite në shtete si: Rumani, Bullgari, Poloni, Letoni, Ceki, Spanjë, Itali, Hungari etj dhe kjo falë marrëveshjeve të bashkëpunimit me IAL në këto vende. UMT është vazhdimisht aktiv dhe në kohencë mbi thirrjet për pjesëmarrje në projekte duke nxitur stafin akademik të përfshihen në projekte kërkimore kombëtare e ndërkombëtare,</p> <p><i>Aneksi Nr.13, Lista e marreveshjeve me IAL-të nderkombetare dhe kombetare.</i></p>

	<i>Aneksi Nr.26 Lista e universiteteve bashkëpunuese në kuader të programit ERASMUS.</i> <i>Aneksi Nr.30, Lista e projekteve te aplikuar dhe të fituara nga UMT</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi II.8</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Siç e kemi thënë edhe më sipër, GJV vëren se FE UMT ka pjesëmarrje në rritje të partneriteteve dhe bashkëpunimit ndërkombëtar me aktorë me reputacion të lartë kërkimor. Po kështu UMT ka zgjeruar bashkëpunimin me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare duke realizuar oponenta të projekteve, realizimin e studimeve dhe publikimeve të përbashkëta në kuadër të projekteve.  <i>Aneksi Nr.13, Lista e marreveshjeve me IAL-të nderkombetare dhe kombetare.</i> <i>Aneksi Nr.30, Lista e projekteve te aplikuar dhe të fituara nga UMT</i>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Nga vizita në IAL u informuam për bashkëpunimin e FE UMT me institucione publike dhe kompani private. Gjithashtu, nëpërmjet internshipeve, UMT ndihmon institucionet publike dhe private me studentë të pregatitur duke i mundësuar atyre që edhe të marrin eksperiencë.  <i>Aneksi Nr.28, Lista e marreveshjeve për zhvillimin e praktikave.</i>
<b>Kriteri 3.</b> Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave	GJV vëren se, FE UMT ka zhvilluar aktivitete si: konferenca, leksione të hapura, seminare, forume dhe tryeza debati me të ftuar vendas apo të huaj ku kanë marrë pjesë stafi akademik dhe studentë të këtij program studimi. Po kështu shkëmbimet në kuadër të Erasmus Mobility forcojnë kontaktet dhe rrisin mundësinë e bashkëpunimit në projekte dhe aktivitete vendore dhe ndërkombëtare.  <i>Tabelat Shqip, tabela 22. Aktivizimi I studentëve në aktivitete të njësisë, tre vitet e fundit.</i> <i>Aneksi Nr.25, Lista e lektorëve të huaj.</i> <i>Aneksi Nr.27, Lista e shkëmbimeve të studentëve në kuadër të Programit ERASMUS.</i>

	<p><i>Aneksi Nr.33, Raporti mbi aktivitetin kërkimor-shkencor të stafit akademik të FE.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.51, Lista e aktiviteteve shkencore.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.55, Lista e shkëmbimeve të stafit në kuadër të Programit ERASMUS.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.57, Lista e leksioneve të hapura.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
				X

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.</p>	<p>GVJ vëren se IAL e zhvillon këtë program studimi në përputhje me standartet e vendosura nga UMT dhe ato shtetërore të cilësisë duke harmonizuar leksionet në kohë reale me ato të vëna në dispozicion nga pedagogu online. Në nivel institucional IAL-ja përdor sistemin edu4school, i cili i bën të mundur studentit në kohë reale të ketë qasje on-line me materialet e e përgatitura nga pedagogu si p.sh. leksione, materiale shtesë audiovizive, si dhe të kryejë vlerësimet për elementë të caktuar të mësimdhënies. Gjithashtu në nivel program-studimi UMT ka vënë në dispozicion edhe udhëzuesin e pedagogut për përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies.</p> <p>Gjatë takimit me stafin akademik të programit të studimit GVJ mori informacion mbi mënyrën e zhvillimit të leksioneve. Për qëllime të realizimit të orëve mësimore dhe të shpërndarjes së dijeve, stafi akademik përdor metoda interaktive dhe gjithëpërfshirëse.</p> <p>Për shkak të periudhës së pandemisë COVID-19, në vitin akademik 2019-2020 stafi akademik ka implementuar metodën e mësimdhënies online dhe ka ofruar për studentët mundësinë e ofrimit të leksioneve duke qënë në komunikim të vazhdueshëm me ta.</p> <p><i>Aneksi Nr.11, Platformat për mesimin online.</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 36

	<p><i>Aneksi Nr.59, Ndërfaqe classroom e një pedagogu.</i>  <i>Aneksi Nr.60, Platformat GTM per mesimin online.</i>  <i>Aneksi Nr.61, Udhezim mbi mesidhenien ne distane.</i>  <i>Aneksi Nr.81, Manual shpjegues i përdorimi të platformës edu4school.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>FE UMT konsideron se përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies mund të arrihet vetëm nëpërmjet operimit të mekanizma të monitorimit dhe vlerësimit të personelit akademik në mënyrë periodike. Vlerësimi kryhet nga</p> <p>i) studentët për elementët e mësimdhënies,</p> <p>ii) monitorimin periodik të performances së personelit akademik dhe aftësive të mësimdhënies nga;</p> <p>iii) si dhe një formular i vetvlerësimit të punës mësimore dhe kërkimore.</p> <p>Në fillimin e vitit akademik, çdo anëtar i personelit akademik kryen parashikimin e ngarkesës vjetore e cila vlerësohet dhe miratohet nga përgjegjësi i departamentit dhe dekanati. Ndërsa në fund të vitit raportohet sërish analiza mësimore e cila integrohet në analizën mësimore kërkimore të njësisë bazë dhe të njësisë kryesore.</p> <p><i>Aneksi Nr.29, Raport vjetor i aktiviteti mësimor, kërkimor dhe shkencor- FE Viti 2021-2022.</i>  <i>Aneksi Nr.48, Model i pyetësorit të studentit per lenden pedagogun.</i>  <i>Aneksi Nr.49, Analiza e NJSBC për pyetësorët SI-2021-2022.</i>  <i>Aneksi Nr.64, Raport monitorimi javor dhe progresiv për mësimdhënien.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Për të patur mendimin e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve UMT garanton përfshirjen e studentëve nëpërmjet pjesëmarrjes së studentëve në anketim për secilën lëndë të zhvilluar si dhe garantimin e ankimimit të rezultatit të provimit sipas procedurës së përcaktuar në rregullore.</p> <p><i>Aneksi Nr.07, Rregullore e UMT.</i>  <i>Aneksi Nr.08, Rregullore e FE-UMT.</i>  <i>Aneksi Nr.37, Rregullore e provimeve.</i>  <i>Aneksi Nr.48, Model i pyetësorit të studentit per lenden pedagogun.</i>  <i>Aneksi Nr.49, Analiza e NJSBC për pyetësorët SI-2021-2022.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Bazuar në të dhënat e siguruar nga këto vlerësime, NJSBC - si struktura përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie dhe kërkimin shkencor, ku përfshihen dhe rezultati i punës së personelit ndihmës akademik - harton raportin vjetor me anë të të cilit informon drejtuesit e njësive, e përmes tyre të gjithë stafin e UMT rreth rezultateve të monitorimeve, në mënyrë që të merren masat e nevojshme për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njësive të tij bazë dhe individëve në të ardhmen. Hartimi i</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 37

	<p>një plani pune nga ana e NJSBC-së dëshmon vullnetin e strukturave drejtuese në IAL për të përmirësuar këto procese.</p> <p><i>Aneksi Nr.29, Raport vjetor i aktiviteti mësimor, kërkimor dhe shkencor- FE Viti 2021-2022.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.49, Analiza e NJSBC për pyetësorët S1-2021-2022.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.62, Rregullorja e NJSBC.</i></p>						
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembujt të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies</p>	<p>Raportet e vlerësimit të performancës së personelit akademik shërben për të evidentuar temat për organizimin e trainimeve specifike lidhur me nevojat e stafit të UMT, por edhe përdoret si bazë për vlerësimin e performancës së stafit si kriter për zbatimin e marrëdhënieve të punësimit i.e. kohëzgjatja, apo shpërblimi. Rezultatet e marra diskutohen edhe në mbledhjet e departamentit dhe dekanatit edhe me pedagogët në mënyrë individuale në fund të vitit akademik kur kryhet vlerësimi i stafit akademik.</p> <p><i>Takimi me zyrën e NJSBC.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.65, Minuta të një mbledhje dekanati.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.29, Raport vjetor i aktiviteti mësimor, kërkimor dhe shkencor- FE Viti 2021-2022.</i></p>						
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht			X
Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht					
		X					

### Standardi III.2

#### Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyra kurse, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Procesi i mësimdhënies dhe mësim nxënies harmonizon format tradicionale si leksionet, seminarët, apo detyrat e kursit, me projekte dhe praktikat profesionale duke mbajtur parasysh ngarkesën në orët mësimore të punës individuale dhe orëve në auditor.</p> <p><i>Aneksi Nr.07, Rregullore e UMT.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.08, Rregullore e FE-UMT.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.18, Plan programet e lëndëvesyllabuset.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të</p>	<p>Personeli akademik përpiqet që të përzgjedhë format më efektive të mësimdhënies duke patur parasysh orën e mësim, karakteristikat e lëndës, numrin dhe nivelin e mësimnxënies së studenteve, literaturën në dispozicion, si edhe kombinimin e aspektit teorik me atë praktik.</p> <p><i>Takimi me Stafin Akademik dhe me studentët,</i></p>

<p>mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p><i>Aneksi Nr.09, Rregullore e programit të studimit në “MSc” në Menaxhim në Inxhinieri.</i> <i>Aneksi Nr.16, Plani mësimor i programit studimor MSc në MI.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>UMT mbështet personelin akademik në procesin e përmirësimit të mësimdhënies duke mundësuar përdorimin e mjeteve didaktike më të përshtatshme për tematikën e trajtuar përfshirë këtu edhe përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie dhe trajnimet për përmirësimin e kompetencave pedagogjike. Auditorët janë të pajisura me mjetet e nevojshme didaktike për të prezantuar video ilustruese për mësimdhënien, për të prezantuar leksionet, ndonëse vazhdojnë përpjekjet për përmirësimin e mëtejshëm.</p> <p><i>Vëzhgimi i mjediseve auditorët, laboratorët, dhe shërbimet për studentët etj.</i> <i>Aneksi Nr.06, Plani strategjik i zhvillimit të UMT.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>GVJ vlerëson që stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie ka përvojën e duhur profesionale dhe akademike në shpjegimin dhe në transmetimin e njohurive dhe koncepteve të cilat ofrohen nga ky program.</p> <p>Numri i PAE në vitin akademik 2022-2023, është 7. Kualifikimet dhe eksperiencia e përfitur brenda dhe jashtë institucionit, si dhe aplikimet në projekte kombëtare, ndihmojnë në zhvillimin dhe përmirësimin e metodave didaktike të përdorura.</p> <p><i>Aneksi Nr.09, Rregullore e programit të studimit në “MSc” në Menaxhim në Inxhinieri.</i> <i>Aneksi Nr.16, Plani mësimor i programit studimor MSc në MI.</i> <i>Aneksi Nr.54, CV e stafit akademik të programit.</i> <i>Tabelat Shqip.</i> <i>Takimi me Stafin Akademik dhe me studentët.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>FE UMT ka si pjesë të strategjisë përmirësimin e kurrikulës dhe përfshirjen e studenteve në këtë proces. Për këtë qëllim shërben pyetëtori i studentëve që zhvillohet në fund të çdo semestri duke ruajtur anonimatën e tyre, si dhe fokus grupeve me studentët dhe përmes opinionëve e mendimeve që ata shprehin në mbledhjet e hapura të departamentit. Megjithatë procesi se si integrohen këto rezultate në kurrikulat e programit nuk është e qartë. Një analizë e rezultateve të përmbledhura të këtyre vlerësimeve i vihet në dispozicion personelit akademik të interesuar dhe autoritetet drejtuese nga ana e NJSBC-së me</p>

	synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së tyre në të ardhmen. <i>Aneksi Nr.07, Rregullore e UMT.</i> <i>Aneksi Nr.08, Rregullore e FE-UMT.</i> <i>Aneksi Nr.48, Model i pyetësorit të studentit për lenden pedagogun.</i> <i>Aneksi Nr.49, Analiza e NJSBC për pyetësorët S1-2021-2022.</i>		
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.	Zhvillimi i orëve mësimore bëhet nëpërmjet metoda interaktive dhe diskutime, për të nxitur mendimin kritik të studentit dhe dialogun me ekspertë të ftuar në auditor apo edhe nepermjet platformave online për ta bërë mësimdhënien më tërheqëse dhe efektive.  <i>Aneksi Nr.11, Platformat per mesimin online.</i> <i>Aneksi Nr.16, Plani mësimor i programit studimor MSc në MI.</i> <i>Takim me studentët e programit të studimit</i>		
<b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre	Personeli akademik gjatë leksioneve dhe seminareve alternon metoda të ndryshme të mesimdhënies për ti dhënë mundësi studenteve që të marrin pjesë në diskutime, të bëjnë analiza dhe të prezantojnë ato në mënyrë bindëse dhe të argumentuar. Në orët mësimore ofrohen për diskutim edhe shembuj dhe situata konkrete me qëllim që studentët të kenë mundësi të reflektojnë nëpërmjet aplikimit direkt kompetencat e zhvilluara si edhe të reflektojnë progresin e arritur në asimilin e programit Marredhenia mes pedagogeve dhe studentëve zhvillohet në respekt të rregullave të komunikimit dhe etikës institucionale.  <i>Takim me stafin akademik dhe me studentët e programit të studimit.</i> <i>Aneksi Nr.09, Rregullore e programit të studimit në "MScr" në Menaxhim në Inxhinieri.</i> <i>Aneksi Nr.16, Plani mësimor i programit studimor MSc në MI.</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

### Standardi III.3

**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.**

#### Kriteret

#### Vlerësimi i ekspertëve

**Kriteri 1.** Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të

Ambientet ku kryhet procesi mësimor plotësojnë standardet për të zhvilluar një mësimdhënie cilësore. Ambientet dhe sallat mësimore kanë hapësirat e nevojshme. Bazuar në dokumentacion, (Tabela 16)



<p>cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>UMT siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike. Infrastruktura është e përshtatshme dhe pajisur me salla leksioni dhe seminari, laboratore dhe bibliotekë.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ evidentoi se institucioni disponon, laboratorë, klasa, zyra, biblioteka, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e këtij program studimi. Referuar RVB, vizitës në institucion dhe të dhënave për infrastukturën, GVJ konstaton se institucioni disponon mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimit e mësimin të programit të studimit.</p> <p><i>Aneksi Nr.69, Relacion teknik per ambientet dhe infrastrukturen e UMT. Tabelat Shqip, tabela 16</i>  <i>Vëzhgim i mjediseve (auditorët, laboratorët, dhe shërbimet për studentët etj.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.</p>	<p>Procesi mësimor zhvillohet në ambientet e pajisura me logjistikën e nevojshme për të siguruar nje aktivitet akademik cilësor. Laboratorët, sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura me mjete audio vizive si PC dhe projektorë.</p> <p>Biblioteka njëkohësisht është e pajisur me PC në mënyrë që studentët të kenë të aksesojnë bibliotekat online. Të gjithë laboratorët janë të pajisur me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin modern të procesit mësimor dhe përfitojnë nga sistem Eireless .</p> <p><i>Aneksi Nr.21, Abjentet për Infrastrukturën FE-UMT.</i>  <i>Aneksi Nr.69, Relacion teknik per ambientet dhe infrastrukturen e UMT.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion, konstaton se në funksion të cilësisë së mësimdhënies institucioni ka aktualisht 2 laboratorë të informatikës. GVJ konstatoi se laboratorët që UMT disponon janë të pajisur me pajisjet e duhura harduerike dhe softuerike që studentëve ju nevojiten.</p> <p>Platforma "Edu4Schools", e cila është një metodë inovative që krijon mundësi për të komunikuar me studentët për aspekte të ndryshme të procesit mësimor kërkimor, përfshin të gjitha format e të mësuarit dhe të dhënies së mësimin, ku materialet e shtypura zëvendësohen me versione elektronike. Pedagogët dhe studentët mund të komunikojne nëpërmjet sistemit informatik duke përdorur materialet online por edhe forumet e hapura ndërsa studentet mund ti kontrollojnë notat dhe materialin akademik online duke patur akses kudo që ndodhen.</p> <p>Për stafin akademik dhe administrativ ka zyra të veçanta.</p> <p><i>Aneksi Nr.71, Manual i menaxhimit të sistemit informatik nga studentët.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion</p>	<p>E gjithë literatura bazë dhe ajo ndihmëse është vënë në dispozicion të studentëve si në formë fizike dhe digjitale. Ndërsa materialet kryesore</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 41



<p>të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara për programin e studimit.</p>	<p>mësimore të programit janë në gjuhën shqipe. Po ashtu ofrohet edhe mundësia për akses nga ana e studentëve e literaturës online dhe pa pagesë (LMS) duke i ofruar studentit mundësinë e shfrytëzimit të një databazë më të plotë dhe të azhurnuar, duke kombinuar literaturën bazë të detyrueshme dhe atë të rekomanduar e cila përgatitet nga pedagogu i lëndës. Pasurimi vazhdueshëm i literaturës së vënë në dispozicion garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, si dhe kërkimin shkencor të parashikuara për programin e studimit.</p> <p>Literatura e cila është në dispozicion ofrohet e printuar dhe elektronike në disa raste me email dhe në disa raste e hedhur në sistemin 'edu4-schools.com'.</p> <p><i>Aneksi Nr.18, Plan programet e lëndëve syllabuset.</i>  <i>Tabelat Shqip, tabela 17</i>  <i>Takim me stafin akademik dhe studentët e programit të studimit.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Studentët mund të shfrytëzojnë mjediset e bibliotekës e pajisur me kompjutera dhe akses në internet. Biblioteka pasurohet edhe me punimet, materialet didaktike dhe librat universitar që depozitohen në bibliotekë. Çdo vit akademik, pedagogët mund të depozitojnë kërkesat e tyre për literaturën e nevojshme dhe mbështetëse të re për tu patur në bibliotekë. Po kështu, biblioteka në bashkëpunim me njësitë kryesore sipas procedurave të përcaktuara, përcakton kërkesat për blerje librash, për shtim titujsh apo edhe kopjesh.</p> <p>Hapësira fizike dhe kapacitetet pritëse të bibliotekës konsiderohen të limituara nga GVJ. Edhe pse nje mjedis qe fton studenët dhe një klimë e mirë aktuale, <i>GVJ do të sugjeronte shtimin e kapaciteteve fizike, posteve dhe pc-ve në bibliotekën e UMT.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.72, Relacion per funksionimin e laboratorve në UMT.</i>  <i>Takom me stafin akademik dhe studentët e programit të studimit.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Infrastruktura e bibliotekës por edhe bibliotekat online (si psh. COBISS+), i ofrojnë studentëve dhe pedagogëve mundësinë për të shfrytëzuar një database kërkimor më të gjerë, si edhe mundësojnë akses në literaturën më të fundit bashkëkohore në lidhje me tematikat e programit.</p> <p>Nga takimi me drejtues të institucionit si dhe me GVB, rezulton se institucioni synon pasurimin e mëtejshëm të bibliotekës, nëpërmjet marrëveshjeve për përdorimin e fondeve të bibliotekave të instucioneve partnere apo shfrytëzimin e U-library në të ardhmen për të cilën është drejt finalizimit marrëveshja.</p> <p><i>Për sa më sipër GVJ është e mendimit që UMT, të gjejë mekanizma të tjerë edhe për rritjen e financimit të mëtejshëm per një fond më të pasur fizik, si dhe për mjedise shfrytëzimi të bibliotekës me kapacitete me te</i></p>

	<p><i>mëdha, duke i praraprirë numrit të studentëve në rritje si dhe numrit me të lartë të programeve</i></p> <p><i>Tabelat Shqip, tabela 17</i></p> <p><i>Takim me stafin akademik dhe studentët e programit të studimit.</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Pranë UMT ka disa laboratore të teknologjisë së informacionit, dhe për lëndë dhe sidomos për tematika të veçanta për programin e studimit mund të përdoren.</p> <p>Studentët mund ti përdorin ambjentet e laboratorëve si edhe bibliotekën, të cilat janë të pajisur me kompjutera dhe internet ndër të tjera edhe për zhvillimin e detyrave të kursit, diplomave etj.</p> <p><i>Aneksi Nr.21, Abjentet për Infrastrukturën FE-UMT.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.69, Relacion teknik per ambjentet dhe infrastrukturen e UMT.</i></p> <p><i>Takimi me studentët e programit të studimit</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>UMT përdor platformën 'edu4schools' në funksion të mësimdhënies. Kjo platformë shërben për informimin e studentëve mbi vlerësimin, oraret, shpërndarjen e informacionit, etj.</p> <p>Gjatë periudhës së pandemisë COVID19 UMT adaptoi sisteme online të cilat u përdorën për procesin e mësimdhënies. Gjatë takimeve, GVJ u informua se këto platforma kanë qënë efektive si për personelin akademik edhe për studentët jo vetëm për periudhën e Covid por edhe në vazhdimësi. Kjo ka lehtësuar studentët ndër të tjera edhe në aksesin gjatë leksioneve.</p> <p><i>Aneksi Nr.59, Ndërfaqe classroom e një pedagogu.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.60, Platformat GTM per mesimin online.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.61, Udhezim mbi mesidhenien ne distance.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.81, Manual shpjegues i përdorimi të platformës edu4school.</i></p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>Personeli akademik dhe studentët përdorin <i>edu4schools</i> edhe për komunikime të brendshme si vlerësimi, notat, kontakte sqaruese për detyrat, shpërndarjen e materialeve mësimore si dhe çdo komunikim tjetër të nevojshëm për mbarëvajtjen e procesit mësimor. Për këtë qëllim përdoren edhe adresat me domainin @umt.edu.al.</p> <p><i>Aneksi Nr.71, Manual i menaxhimit të sistemit informatik nga studentët.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.81, Manual shpjegues i përdorimi të platformës edu4school.</i></p>
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre</p>	<p>Në këtë program detyrimet përmbyllëse, që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës, kanë 18 kredite ECTS ose 15 % e krediteve. Teza e diplomës është punë e pavarur në formën e një studimi analitik që lidhet me formimin e marrë gjatë programit. Në përfundim të diplomimit, studentit pajiset me diplomën përkatëse Master i Shkencave e cila firmoset nga dekani i FE dhe Rektori i UMT.</p>

	<p>Nga takimi me studentët që ndjekin këtë program studimi u informuam për procedurën e caktimit të temës me pedagogun udhëheqës. Nga vlerësimi i dosjes së dokumentacionit të paraqitur nga IAL, vihet re që studentëve iu mundësohet një udhëzues për përgatitjen e mikrotezes dhe elementëve përbërës të saj si dhe formati që duhet të ndjekë studenti në punimin e saj. Për udhëheqjen e diplomës angazhohet staf akademik PAE me tituj dhe grada. Në këtë kuadër puna e studentëve drejtohet edhe nga procedura dhe plani I punës për përgatitjen dhe mbrojtjen e mikrotezës.</p> <p><i>Aneksi Nr.09, Rregullore e programit të studimit në "MSc" në Menaxhim në Inxhinieri.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.40. Procedurat e përgatitjes dhe mbrojtjes së diplomës-MSc-MI.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.41, Modeli i diplomës-Msc në Menaxhim ne Inxhinieri.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.42, Suplement diplome-Msc në Menaxhim ne Inxhinieri.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.73, Plan pune për punimin e diplomës-Msc ne Menaxhim ne Inxhinieri.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi III.4</b>	
<b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>UMT ka ngritur struktura në nivel institucional dhe fakulteti për të promovuar dhe përmirësuar cilësinë e mësimdhënies. Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamentet, dorëzojnë në Rektorat çdo fund viti akademik, një raport vjetor, i konceptuar si një model i vlerësimit të brendshëm të njësisë. Ky raport shërben për të patur një pasqyrë të fakultetit dhe për t'u përmirësuar në vazhdimësi.</p> <p>Në nivel institucional, për monitorimin e procesit të mësimdhënies një funksion të rëndësishëm ka dhe "Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë" (NJSBC) e cila ndër detyrat e shumta që mban, ka si detyrë edhe monitorimin e procesit mësimor dhe mbledhjen e të dhënave të studentëve mbi procesin e mësimdhënies. Kjo njësi analizon të dhënat e mbledhura dhe i shpërndan ato tek përgjigjësi përkatës i njësisë bazë.</p>

	<p>Më pas drejtuesi i njësisë bazë ka për detyrim të shpërndaj informacionin e marrë nga pyetësorët dhe ta diskutoj atë me lektorin përkatës.</p> <p>Gjithashtu kjo drejtori ka një rol të rëndësishëm në analizimin e ndryshimeve ligjore dhe përshtatjen e tyre me planet mësimore të ofruara nga UMT. Planet mësimore për hapjen e programeve të reja, apo për ndryshimet në programet ekzistuese kontrollohen nga NJSBC për pjesën ligjore dhe për përshtatjen e tyre me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi. Gjatë takimit me NJSBC u vu në dukje se kjo njësi nuk ndërhyr në cilësinë apo në planifikimin e planit mësimor, pasi kjo është kompetencë e plotë e njësisë bazë.</p> <p><i>Aneksi Nr.29, Raport vjetor i aktiviteti mësimor, kërkimor dhe shkencor- FE Viti 2021-2022.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.49, Analiza e NJSBC për pyetësorët S1-2021-2022.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.74, Përbërja e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë-2022.</i></p> <p><i>RVB</i></p> <p><i>Takimi me përfaqësues të NJSBC</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.</p>	<p>Njësia kryesore Fakulteti i Ekonomisë, dhe njësia bazë Departamenti i Informatikës Ekonomike, duke u mbështetur në kontrollin e vazhdueshëm dhe masave të marra, të leksioneve të hapura të organizuara, si dhe të analizës së vazhdueshme të punës mësimore dhe kërkimit shkencor, krijon frymën e përgjegjësive individuale të personelit akademik për rritjen e cilësisë së mësimdhënies në këtë program studimi. Dekani si drejtues i fakultetit mbikqyr mbarvajtjen e veprimtarisë mësimore dhe shkencore në njësinë bazë, duke koordinuar dhe bashkëpunuar me drejtuesin e njësisë bazë.</p> <p>Përgjegjësi i Departamentit të Informatikës Ekonomike, drejton dhe kontrollon punën mësimore, nxit dhe motivon stafin akademik për përmbushjen e procesit mësimor, realizimit të detyrave dhe kërkimin shkencor (Rregullore FE UMT, Neni 13).</p> <p>Gjatë takimit me përgjegjës të njësisë bazë dhe anëtarët e departamentit, GVJ ju vu në dukje se përgjegjësi luan një rol të rëndësishëm në motivimin e stafit, kontrollin e punës mësimore, kontrollin e syllabuseve dhe nxitjen e stafit për pjesëmarrje në konferenca dhe botime shkencore.</p> <p><i>Aneksi Nr.08, Rregullore e FE-UMT.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.09, Rregullore e programit të studimit në "MSc" në Menaxhim në Inxhinieri.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.64, Raport monitorimi javor dhe progresiv për mësimdhënien.</i></p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>UMT nxit zbatimin e metodave të reja dhe inovative të mësimdhënies duke përdorur më gjerësisht nga fillimi i vitit teknologjinë informative si LMS.</p> <p>Personeli akademik i Fakultetit të Ekonomisë dhe Departamentit të Informatikës Ekonomike, kualifikohen brenda institucionit dhe jashtë tij në kuadër të zbatimit të marrëveshjeve me institucione të tjera homologe përmes tryezave të rrumbullakëta, diskutimeve, leksioneve të hapura, apo mobilitete të stafit.</p> <p>Këto aktivitete kanë shërbyer si trajnime për stafin akademik dhe përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe përshtatjes së metodave të reja në të.</p> <p><i>Aneksi Nr.26 Lista e universiteteve bashkëpunuese në kuadër të programit ERASMUS.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.55, Lista e shkëmbimeve të stafit në kuadër të Programit ERASMUS.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.57, Lista e leksioneve të hapura.</i></p> <p><i>Takim me Drejtuesin e Departamentit të Informatikës Ekonomike</i></p> <p><i>Takim me stafin akademik të programit të studimit.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Stafi akademik i angazhuar në përgatitjen e programit të studimit kombinon mësimdhënien me kërkimin shkencor për kualifikimin e mëtejshëm të stafit akademik në zbatim edhe të direktivave dhe rekomandimeve të paraqitura në Planin strategjik i zhvillimit të UMT. Në këtë aspekt programi studimi ka kryer më shumë aktivitete duke përfutur edhe nga projektet.</p> <p><i>Aneksi Nr.06, Plani strategjik i zhvillimit të UMT.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.30, Lista e projekteve të aplikuara dhe të fituara nga UMT.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Trajnimi i personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja zhvillohet në nivel institucioni nëpërmjet trainimeve tematike, periudhave të shkurtra të shkëmbimit të eksperiencës në universitete partnere, në aktivitete në kuadër të projekteve KA1 Erasmus+, tavolina të rrumbullakta, seminare me pjesëmarrjen e akademikëve të huaj dhe profesionistëve nga fusha dhe tematika të caktuara.</p> <p><i>Aneksi Nr.25, Lista e lektorëve të huaj.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.26 Lista e universiteteve bashkëpunuese në kuadër të programit ERASMUS.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.55, Lista e shkëmbimeve të stafit në kuadër të Programit ERASMUS.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.57, Lista e leksioneve të hapura.</i></p>

<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Personeli akademik që është përgjegjës për zbatimin dhe cilësinë e mësimdhënies merr një ndihmë të vazhdueshme nga personeli ndihmë akademik për sigurimin e një procesi cilësor të mësimdhënies por edhe përmirësimin e mëtejshëm të këtij procesi. Pedagogu është përgjegjës për përgatitjen dhe rishikimin e vazhdueshëm të syllabuseve, literaturës, si edhe të gjithë elementëve të tjerë të parashikuar në procesin e mësimdhënies.</p> <p><i>Aneksi Nr.07, Rregullore e UMT.</i>  <i>Aneksi Nr.08, Rregullore e FE-UMT.</i>  <i>Aneksi Nr.09, Rregullore e programit të studimit në "MScR" në Menaxhim në Inxhinieri.</i></p>		
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Gjatë takimit që GVJ pati me stafin akademik në lidhje me metodat e mësimdhënies dhe u komunikua se synohet më tepër mësimdhënie në mënyrë interaktive duke aktivizuar edhe studentët gjatë leksioneve por edhe duke përdorur teknologjitë e informacionit.. Seminaret zhvillohen duke trajtuar përveç aspekteve teorike, raste studimesh, video etj.</p> <p><i>Aneksi Nr.29, Raport vjetor i aktiviteti mësimor, kërkimor dhe shkencor- FE Viti 2021-2022.</i>  <i>Takimi me stafin akademik të programit të studimit</i></p>		
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor</p>	<p>Në funksion të përmirësimit të procesit të mësimdhënies, UMT ka përfshirë në procesin e mësimdhënies lektorë të ndryshëm vendas apo të huaj, falë bashkëpunimeve në kuadër të programeve të bashkëpunimit. Si u përmend edhe me lart UMT është përfshirë në aktivitete në kuadër të projekteve KA1 Erasmus+, tavolina të rumbullakta, seminare me pjesëmarrjen e akademikëve të huaj dhe profesionistëve nga fusha dhe tematika të caktuara.</p> <p><i>Aneksi Nr.25, Lista e lektorëve të huaj.</i>  <i>Aneksi Nr.26 Lista e universiteteve bashkëpunuese në kuadër të programit ERASMUS.</i>  <i>Aneksi Nr.55, Lista e shkëmbimeve të stafit në kuadër të Programit ERASMUS.</i>  <i>Aneksi Nr.57, Lista e leksioneve të hapura.</i></p>		
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p>Përbushet plotësisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi III.5**

**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e kërkimore dhe garanton zbatimin e tyre.**

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 47

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>GVJ konstatoi nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe nga vizita në UMT, se institucioni përdor metoda të efektshme të vlerësimit të dijeve të studentëve, për realizimin e qëllimeve dhe objektivave, me fokus parësor aftësimin e tyre. Konkretisht, në përputhje me parashikimet në syllabuse, metodat e vlerësimit përfshijnë testimet, detyra kursi dhe provime përfundimtare. Format e kriteret e vlerësimit të dijeve për studentët janë të përcaktuara në Rregulloren e Fakultetit dhe në Rregulloren e Programit të studimit.</p> <p>Kontrolli i njohurive të studentëve sipas rregullores së UMT realizohet nëpërmjet: angazhimit në diskutime gjatë leksioneve e seminareve, por edhe në formë kolegjumesh dhe detyrash të kontrolluara përgjatë zhvillimit të lëndës; detyrave të kursit që lidhen me problematikën e disipline; provimit të ndërmjetëm dhe përfundimtar mbi bazën e materialeve të trajtuara përgjatë zhvillimit të lëndës. Sistemi i vlerësimit të studentëve është i njëjtë për të gjitha programet me karakter profesional dhe programet e studimit të ofruar në UMT dhe realizohet nëpërmjet sistemit të vlerësimit nga nota 1 deri në 10, ku nota 5 rezulton si notë kaluese. Kontrolli i dijeve të studentëve bëhet sipas kriterëve të përcaktuara ku:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive së bashku me plotësimin e detyrimeve (detyrave të kursit) - 10%,</li> <li>• detyrimet e lëndës (laboratore ose detyra kursi)- 20%</li> <li>• testimet gjatë vitit (ose provimi ndërmjetëm) - 10%</li> <li>• provimi përfundimtar - 60%.</li> </ul> <p>Mënyra e vlerësimit dhe kriteret i bëhen me dije studentëve, që në fillim të vitit akademik dhe janë pjesë përbërëse e syllabuseve të lëndëve.</p> <p><i>Aneksi Nr.09, Rregullore e programit të studimit në "MSc" në Menaxhim në Inxhinieri.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.18, Plan programet e lëndëve syllabuset.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.37, Rregullore e provimeve.</i></p> <p><i>Tabelat Shqip, tabela 15</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në fillim të lëndës në çdo semester, pedagogu i lëndës i nje studentët me syllabusin e lëndës, në të cilin përcaktohen në mënyrë të detajuar emërimi dhe kreditet e lëndës, pedagogu i lëndës, vit/ semestri kur zhvillohet lënda, vendi që zë lënda në formimin e studentit, ngarkesa e orëve në auditor dhe jashtë tij, literatura e detyruar, si edhe mënyra e kontrollit dhe format e vlerësimit të dijeve, së bashku me afatet kur duhet të plotësohet secili detyrim deri në përfundim të zhvillimit të lëndës.</p>



	<p><i>Aneksi Nr.09, Rregullore e programit të studimit në "MSc" në Menaxhim në Inxhinieri.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.16, Plani mësimor i programit studimor MSc në MI.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.18, Plan programet e lëndëve syllabuset.</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara</p>	<p>Bazuar në rregulloret e UMT-së, Rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë, rregulloren e programit të studimit janë përcaktuar edhe format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të njohurive që ka përvetsuar studentit gjatë zhvillimit teorik e praktik të lëndës/modulit si aktivizim në mësim, si testimi i ndërmjetëm/detyrat e kontrollit, detyrat e kursit dhe provimi final, për të testuar sa më realisht njohuritë dhe kompetencat e studentëve.</p> <p><i>Aneksi Nr.07, Rregullore e UMT- kreu V-Vlerësimi I dijeve</i></p> <p><i>Aneksi Nr.08, Rregullore e FE-UMT- neni 59-67.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.09, Rregullore e programit të studimit në "MSc" në Menaxhim në Inxhinieri- Kreu V-Vlerësimi I studentit</i></p> <p><i>Aneksi Nr.18, Plan programet e lëndëve syllabuset.</i></p> <p><i>Tabelat Shqip, tabela 15</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			X	

<p><b>Standardi III.6</b></p> <p><b>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..</b></p>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.</p>	<p>Vlerësimi i njohurive të studentëve realizohet nëpërmjet një kontrolli të vazhdueshëm të shprehura si përqindje (0-100%) e notës përfundimtare. Niveli i të nxënit vlerësohet përmes detyrave me shkrim dhe /ose me gojë duke përfshirë angazhimin në diskutime gjatë orëve mësimore. Kështu në këtë program studimi, aktivizimi gjatë leksioneve dhe seminareve vlerësohet me 10% të vlerësimit total, detyrat e kursit me 20% të vlerësimit, provimi i ndërmjetëm 10% të vlerësimit si dhe ai përfundimtar 60% e vlerësimit.</p> <p>GVJ mendon që shpërndarja e ngarkesës dhe vlerësimit gjatë gjithë vitit e mban studentin të angazhuar në mënyrë më efektive.</p> <p>Provimin final realizohet me shkrim sipas rregulloreve të UMT, të programit të studimit etj.</p> <p><i>Aneksi Nr.07, Rregullore e UMT- kreu V-Vlerësimi I dijeve</i></p>

	<p><i>Aneksi Nr.08, Rregullore e FE-UMT- neni 59-67.</i>  <i>Aneksi Nr.09, Rregullore e programit të studimit në "MScr" në Menaxhim në Inxhinieri- Kreu V-Vlerësimi I studentit</i>  <i>Aneksi Nr.18, Plan programet e lëndëve syllabuset.</i>  <i>Tabelat Shqip, tabela 15</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Testimi i njohurive me shkrim bëhet me anë të sekretimit (sistemi barcode), proces i cili realizohet nën mbikqyrjen e sekretarisë mësimore, dhe garanton anonimatin dhe eliminon format e ndryshme të abuzimit duke rritur transparencën.</p> <p><i>Aneksi Nr.37, Rregullore e provimeve.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Për vlerësimin e provimeve angazhohen të paktën 2 anëtarë që drejtohen nga titullari i lëndës.</p> <p>Tezat e provimit hartohet nga pedagogu i lëndës, nënshkruhen nga përgjegjësi i departamentit dhe ndryshohen rregullisht duke patur si qëllim që të vlerësojnë njohuritë e studentëve. Studentët merren në provim nga një komision i përbërë nga dy pedagogë të lëndës, nga titullari i lëndës, i cili është përgjegjës dhe ndjek zhvillimin e provimit.</p> <p><i>Aneksi Nr.07, Rregullore e UMT- kreu V-Vlerësimi I dijeve</i>  <i>Aneksi Nr.08, Rregullore e FE-UMT- neni 59-67.</i>  <i>Aneksi Nr.09, Rregullore e programit të studimit në "MScr" në Menaxhim në Inxhinieri- Kreu V-Vlerësimi I studentit</i>  <i>Aneksi Nr.37, Rregullore e provimeve.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.</p>	<p>Bazuar në rregulloret e studimeve të UMT-së, Rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë, rregulloren e programit të studimit janë përcaktuar edhe format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të njohurive që ka përvetsuar studenti gjatë zhvillimit teorik e praktik të lëndës/modulit si aktivizim në mësim, si testimi i ndërmjetëm/detyrat e kontrollit, detyrat e kursit dhe provimi final, për të testuar sa më realisht njohuritë dhe kompetenat e studentëve.</p> <p>Testimi i njohurive me shkrim bëhet me anë të sekretimit (sistemi barcode), proces i cili realizohet nën mbikqyrjen e sekretarisë mësimore, dhe garanton anonimatin dhe eliminon format e ndryshme të abuzimit duke rritur transparencën.</p> <p><i>Aneksi Nr.07, Rregullore e UMT- kreu V-Vlerësimi I dijeve</i>  <i>Aneksi Nr.08, Rregullore e FE-UMT- neni 59-67.</i>  <i>Aneksi Nr.09, Rregullore e programit të studimit në "MScr" në Menaxhim në Inxhinieri- Kreu V-Vlerësimi I studentit</i>  <i>Aneksi Nr.37, Rregullore e provimeve.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/</p>	<p>Gjatë takimit me studentët, GVJ u informua që ata orientohen që në fillim të lëndës nga pedagogët në lidhje me programin e lëndës dhe</p>

<p>feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>detyrimeve të saj, me testimet e ndërmjetme, me pikët që i korespondojnë atyre, me strukturën e detyrave e projekteve të kursit. Në vazhdim ata instruktohen me mënyrën se si do të realizojnë detyrën e kursit apo projektit, i cili në fund të lëndës apo modulit prezantohet nga studentët para kursit të tyre dhe pedagogut të lëndës (kjo bëhet në forma të ndryshme sipas rastit në ppt, foto, video, në orët e fundit të seminareve).</p> <p>Një procedurë e tillë mundëson marrjen e feedback-ut si nga pedagogu ashtu dhe nga studentët e tjerë në lidhje me aspektet pozitive të punimit apo elementët që kanë nevojë për përmirësim apo detajim të mëtejshëm. Ky proces ballafaqimi me një audiencë të caktuar ndihmon studentët të përmirësohen në drejtim të mësimnxënies si dhe të fitojnë/ përmirësojnë aftësitë e tyre prezantuese.</p> <p><i>Aneksi Nr.07, Rregullore e UMT- kreu V-Vlerësimi I dijeve</i>  <i>Aneksi Nr.08, Rregullore e FE-UMT- neni 59-67.</i>  <i>Aneksi Nr.09, Rregullore e programit të studimit në "MScr" në Menaxhim në Inxhinieri- Kreu V-Vlerësimi I studentit</i>  <i>Aneksi Nr.18, Plan programet e lëndëve syllabuset.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Ne rregulloren e UMT janë të paraqitura rregullat e zhvillimit të provimit. UMT nuk lejon kopjimin por gjithashtu edhe në përgatitjen e detyrave të kursit por sidomos të punimit të diplomës nuk lejohet plagjiatura.</p> <p>Udhëzimet për punimet e diplomës përcaktojnë rregullat e qarta të punimit të diplomës.</p> <p><i>Aneksi Nr.07, Rregullore e UMT</i>  <i>Aneksi Nr.40. Procedurat e përgatitjes dhe mbrojtjes së diplomës-MSc-MI.</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Vlerësimi i dijeve dhe njohurive të fituara nga studentët e këtij programi bëhet në zbatim të Rregullores së Përgjithshme të UMT, FE dhe rregullores së programit të studimit. Pedagogu vlerëson me pikë secilin komponent të tezës. Pas korrigjimit provimet dorëzohen brenda 3 ditëve në sekretarinë mësimore së bashku me procesverbalet përkatëse. Notat i jepen studentit nga sekretaria mësimore ose nëpërmjet aksesit online. Vlerësimi për komponentët e tjerë i dorëzohet studentit përpara zhvillimit të provimit përfundimtar, dhe pedagogu nuk ka të drejtë të ndërhyjë për ndryshimin e tyre pas zbardhjes së rezultateve të provimeve</p> <p><i>Aneksi Nr.07, Rregullore e UMT- kreu V-Vlerësimi I dijeve</i>  <i>Aneksi Nr.08, Rregullore e FE-UMT- neni 59-67.</i>  <i>Aneksi Nr.37, Rregullore e provimeve</i></p>

<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Studenti ka të drejtë që të ankohet për vlerësimin e provimit dhe ankesa i paraqitet me shkrim pedadohut të lëndës dhe komisionit të provimit, i cili nëse verifikon shkelje të korrigjueshme ndërmerr hapat e nevojshëm së bashku me komisionin e provimit.</p> <p><i>Aneksi Nr.07, Rregullore e UMT- kreu V-Vlerësimi I dijeve</i>  <i>Aneksi Nr.08, Rregullore e FE-UMT- neni 59-67.</i>  <i>Aneksi Nr.37, Rregullore e provimeve</i></p>		
<p><b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet</p>	<p>Në rast se studenti nuk është i bindur për vlerësimin korrekt nga ana e pedagogut, atëherë ankohet me shkrim pranë Përgjegjësit të Departamentit dhe kur e gjen të pamundur zgjidhjen e problemit e përcjell tek dekani. Dekanit ngre një komision ad-hoc për verifikimin e pretendimeve të studentit dhe përcakton vlerësimin përfundimtar. Vlerësimi i Komisionit që ngrihet është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi i kontestuar. Procesverbalet e vlerësimit firmosen dhe dorëzohen në Sekretarinë Mësimore.</p> <p><i>Aneksi Nr.07, Rregullore e UMT- kreu V-Vlerësimi I dijeve</i>  <i>Aneksi Nr.19, Rregullore e Sekretarisë.</i>  <i>Aneksi Nr.37, Rregullore e provimeve</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi III.7</b>  <b>Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Kurrikula e programit të studimit përmban module dhe lëndë bazë, lëndë karakterizuese dhe plotësuese, nëpërmjet të cilave studenti thellon njohuritë dhe zhvillon aftësitë profesionale e të veçanta në funksion të manaxhimit dhe vendimmarrjes së biznesit.</p> <p>Ky program studimi ka për qëllim tu ofrojë të diplomuarve, kompetenca të avancuara profesionale për formimin e ekspertëve të mirëfilltë në fushën e menaxhimit të projekteve por jo vetëm. Gjithashtu ky program studimi gërsheton njohuri teorike dhe praktike për të inkurajuar te studenti mendimin kritik dhe krijues si dhe për ti ekspozuar ata drejt çështjeve bashkëkohore dhe kyçe në fushën e menaxhimit në fusha të ndryshme të inxhinierisë suke</p>

	<p>synuar vazhdimisht zbatimin e parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm.</p> <p><i>Aneksi Nr.09, Rregullore e programit të studimit në "MSc" në Menaxhim në Inxhinieri.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.16, Plani mësimor i programit studimor MSc në MI.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit GVJ konstatoi se modulet/lëndët janë në përputhje me zbatimin e VKM 41/2018 të ndara në lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe detyrimeve përmblyëse.</p> <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni si edhe në takimin me studentët dhe lektorët e këtij programi studimi, programi garanton një sërë njohurish të përshtatshme për tregun e punës.</p> <p><i>Aneksi Nr.09, Rregullore e programit të studimit në "MSc" në Menaxhim në Inxhinieri.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.16, Plani mësimor i programit studimor MSc në MI.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.</p>	<p>Si rregull, në përfundimit të lëndës pedagogu bën një përmbledhje të koncepteve dhe çështjeve kryesore të zhvilluara, duke përfshirë në diskutim edhe studentët dhe duke marrë mendimin e tyre për çfarë mund të përmirësohet në vijim. Gjithashtu eseja apo detyra e kursit që zhvillohen janë një formë e shqyrtimit të aftësive që kanë përfituar studentët nga lënda</p> <p><i>Aneksi Nr.18, Plan programet e lëndëve syllabuset</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.</p>	<p>Në përfundim të lëndës pedagogu rikthen në fokus për studentët çështjet apo konceptet më të rëndësishme të trajtuara si dhe jep orientimet e nevojshme për përgatitjen për provim. Gjithashtu pedagogu është në dispozicion të studentëve për konsultime përpara provimit edhe gjatë orëve të takimit zyrtar, sipas grafikut të shpallur në fillim të semestrit.</p> <p><i>Takimi me stafin akademik të angazhuar në programin e studimit</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Stafi akademik zhvillon seminare dhe leksione të hapura jashtë orarit mësimor me lektorë apo ekspertë të ftuar me qëllim që të informojë kolegët dhe studentët e interesuar mbi zhvillimet më të fundit sipas fushave të tyre të studimit. Sikurse u përmend dhe më sipër institucioni përdor kryesisht mobilitetet për kualifikimin e mëtejshëm të stafit, por gjithashtu konfirmuar edhe nga intervista me stafin organizohen edhe trajnime specifike. Kualifikimi I vazhdueshëm në fushën profesionale dhe atë të mësimdhënies, sikurse edhe kërkimi shkencor janë pjesë e Planit të Strategjisë UMT.</p>

	<p><i>Aneksi Nr.06, Plani strategjik i zhvillimit të UMT.</i>  <i>Aneksi Nr.25, Lista e lektorëve të huaj.</i>  <i>Aneksi Nr.57, Lista e leksioneve të hapura.</i>  <i>Aneksi Nr.55, Lista e shkëmbimeve të stafit në kuadër të Programit ERASMUS.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>GVJ konstatoi se përbërja e kurrikulës së programit të studimit, lëndët dhe modulet që e përbëjnë atë, janë të ndërtuara në mënyrë të tillë që t'i pajisin studentet me aftësi për t'ju përgjigjur kërkesave të tregut të punës. Kurikula e programit të studimit përmban zhvillimin e praktikës mësimore në vitin e dytë. Hartimi i planit mësimor është bërë në mënyrë të tillë që t'i japë hapësirë studentit për të zhvilluar praktikën profesionale.</p> <p>Ky organizim i kurrikulës u jep mundësinë studentëve për t'i zhvilluar më tej aftësitë dhe kompetencat e fituara në trajtimet e programit të studimit në praktikë. Institucioni ka projekte në të cilat përfshihen studentët dhe ka mobilitete të shumta, në të cilat edhe studentët e këtij programi studimi janë të përfshirë në to.</p> <p><i>Aneksi Nr.09, Rregullore e programit të studimit në "MSc" në Menaxhim në Inxhinieri.</i>  <i>Aneksi Nr.16, Plani mësimor i programit studimor MSc në MI.</i>  <i>Aneksi Nr.17, Dokumentacioni i praktikës për programin e studimit. Tabelat Shqip, tabela nr.22.</i>  <i>Aneksi Nr.27, Lista e shkëmbimeve të studentëve në kuadër të Programit ERASMUS.</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Përmes detyrave të kursit dhe rasteve të studimit të situatave reale apo edhe diskutimet me ekspertë të jashtëm, stafi akademik inkurajon përfshirjen e studentëve në punën kërkimore shkencore.</p> <p><i>Takimi me stafin akademik dhe studentët</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.</p>	<p>Për të nxitur një klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve novative, stafi akademik përpiqet të organizojë dhe mbështesë studentët në zbatimin e aktivitete specifike duke nxitur studentët të marrin pjesë në konferenca shkencore. Gjithashtu sistemi i Alumni bën të mundur që ish studentë të programit të studimit të ftohen për të ndarë eksperiencat e tyre. Qendra e karrieres fton gjithashtu përfaqësues të bizneseve që në bashkëpunim me personelin akademik zhvillojnë tavolina të rrumbullakëta rreth ideve të biznesit.</p> <p><i>Takimi me stafin akademik dhe studentët</i>  <i>Aneksi Nr.14, Rrjeti Alumni UMT.</i>  <i>Aneksi Nr.25, Lista e lektorëve të huaj.</i></p>

	<i>Aneksi Nr.57, Lista e leksioneve te hapura.</i>		
<b>Kriteri 9.</b> Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	<p>Programi synon vendosjen e kërkimit shkencor në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies e mësimnxënies nëpërmjet ngritjes së kualifikimit dhe ekspertizës së stafit akademik, por edhe transferimit të arritjeve bashkëkohore në fushën e shkencës tek studentët, nëpërmjet përfshirjes së tyre në projekte. GVJ evidenton bashkëpunime midis pedagogëve dhe studentëve në kërkimet shkencore si edhe në projekte duke mundësuar që studentët të aftësohen më tej për karrierën e tyre profesionale.</p> <p><i>Aneksi Nr.27, Lista e shkëmbimeve të studentëve në kuadër të Programit ERASMUS.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.51, Lista e aktiviteteve shkencore.</i></p>		
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve	<p>Ndërkombëtarizimi është pjesë integrale e UMT. Programet e mobiliteteve zhvillohen me pjesëmarrjen e studentëve dhe pedagogëve si per shembull +KA107 apo programe mobiliteti për studentët.</p> <p><i>Aneksi Nr.27, Lista e shkëmbimeve të studentëve në kuadër të Programit ERASMUS.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.26 Lista e universiteteve bashkëpunuese në kuadër të programit ERASMUS.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.55, Lista e shkëmbimeve të stafit në kuadër të Programit ERASMUS.</i></p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

### Standardi III.8

**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	<p>Programi i studimit përfundon me Mbrojtjen e Temës së Diplomës një provim publik përpara një komisioni, i cili përbëhet nga dy pedagogë dhe ngrihet për këtë qëllim. Studentët duhet të kenë përfunduar me sukses të gjitha lëndët e kërkuara dhe dorëzimin e tezës në mënyrë që të kualifikohen për mbrojtjen e temës. Teza është një projekt studimor individual i studentit në fushat e specializimit të tij.</p> <p><i>Aneksi Nr.07, Rregullore e UMT.</i></p>

	<i>Aneksi Nr.40. Procedurat e përgatitjes dhe mbrojtjes së diplomës-MSc-MI.</i>
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	<p>Studenti udhëhiqet gjatë periudhës së përgatitjes së tezës nga pedagogë me ekspertizë në fushën e specializimit. Për përgatitjen e tezës studentit i ofrohet edhe një ndihmë e specializuar nëpërmjet një udhëzuesi, i cili ofron të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me procedurat dhe hapat që duhen ndjekur nga studentët për zhvillimin e tezës. Studenti asistohet edhe përmes takimeve të tjera me pedagogun udhëheqës dhe komunikimit përmes e-mailit dhe platformave të tjera LMS, që janë në dispozicion të studentit dhe pedagogut udhëheqës.</p> <p><i>Aneksi Nr.07, Rregullore e UMT.</i>  <i>Aneksi Nr.40. Procedurat e përgatitjes dhe mbrojtjes së diplomës-MSc-MI.</i>  <i>Aneksi Nr.73, Plan pune për punimin e diplomës-Msc ne Menaxhim ne Inxhinieri.</i></p>
<b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	N/A
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.	<p>Udhëheqësit e temave të diplomës janë personel akademik efektiv i UMT i profilizuar në fushën përkatëse. Përzgjedhja e temave bëhet nga studentët në bazë të temave që paraqesin ata ose pedagogët e programit. Udhëheqja e studentit bëhet nga udhëheqësi i tezës i miratur nga departamenti në bazë të dispozitave në fuqi. Kërkesa për të propozuar temat dhe pedagogun udhëheqës bëhet pranë departamenti.</p> <p><i>Aneksi Nr.09, Rregullore e programit të studimit në "MSc" në Menaxhim në Inxhinieri.</i>  <i>Aneksi Nr.40. Procedurat e përgatitjes dhe mbrojtjes së diplomës-MSc-MI.</i>  <i>Aneksi Nr.73, Plan pune për punimin e diplomës-Msc ne Menaxhim ne Inxhinieri.</i>  <i>Takimi me stafin dhe studentet</i></p>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Në përgatitjen e temës së diplomës studentët ndihmohen nga stafi i programit për realizimin e detyrimeve akademike ose kërkimore, hedhjen e të dhënave grafike apo statistikore, përpunimin e pyetësorëve apo anketave duke përdorur të gjithë infrastrukturën e bibliotekave, sallave të kompjuterave por edhe duke shfrytëzuar



	<p>bazën kërkimore të institucioneve të tjera me të cilat programi ka marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p><i>Aneksi Nr.40. Procedurat e përgatitjes dhe mbrojtjes së diplomës-MSc-MI.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.73, Plan pune për punimin e diplomës-Msc ne Menaxhim ne Inxhinieri.</i></p> <p><i>Takimi me stafin dhe studentet</i></p> <p><i>Vizita ne IAL, sallat e kompjuterave</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Udhëheqësi i temave të diplomës e mentoron studentin gjatë gjithë periudhës së përgatitjes së saj duke e orientuar studentin për përgatitjen e temës në zbatim të udhëzuesve të miratuar dhe në përmbushje të standarteve akademike. Punimi i diplomës duhet të respektojë kërkesat e formatit dhe rregullat e etikës akademike. Në përfundim, udhëheqësi i temës nënshkruan temën e diplomës që do të mbrohet përpara komisionit të krijuar nga Departamenti.</p> <p><i>Aneksi Nr.09, Rregullore e programit të studimit në "MSc" në Menaxhim në Inxhinieri.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.40. Procedurat e përgatitjes dhe mbrojtjes së diplomës-MSc-MI.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.73, Plan pune për punimin e diplomës-Msc ne Menaxhim ne Inxhinieri.</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Për vlerësimin (notën) e tezës së masterit vendos komisioni i ngritur për këtë qëllim. Sezonet e rregullta të mbrojtjes së diplomës janë ato të verës, vjeshtës dhe dimrit ndërsa sezona specifike mund të përcaktohen me urdhër të Dekanit. Anëtarët e komisionit vendosin notën për studentin dhe firmosin në procesverbalin e vlerësimit të mbrojtjes së diplomës.</p> <p><i>Aneksi Nr.77, Model i Proces-verbalit te vlerësimit nga komisioni i mbrojtjes diplomës.</i></p> <p><i>Aneksi Nr.78, Vendim dekani per ngritjen e komisionit të mbrojtjes diplomës.</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Në përfundim të përmbushjes së të gjitha detyrimeve akademike, studentin pajiset me diplomën Master i Shkencave në "Menaxhim në Inxhinieri" dhe suplementin e saj, sipas formatit të miratur nga MASR dhe i firmosur nga Dekani i FE dhe Rektori i UMT.</p> <p><i>Aneksi Nr.09, Rregullore e programit të studimit në "MSc" në Menaxhim në Inxhinieri</i></p> <p><i>Aneksi Nr.41, Modeli i diplomës-Msc në Menaxhim ne Inxhinieri</i></p> <p><i>Aneksi Nr.42, Suplement diplome-Msc në Menaxhim ne Inxhinieri.</i></p>

<p><b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të programit, me kërkesën e tij, studentit i vihet në dispozicion një kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p> <p><i>Aneksi Nr.41, Modeli i diplomës-Msc në Menaxhim ne Inxhinieri</i>  <i>Aneksi Nr.42, Suplement diplome-Msc në Menaxhim ne Inxhinieri.</i></p>		
<p><b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen</p>	<p>Pas përfundimit të studimeve, kopje e dokumentacionit të studentit të regjistruar arkivohet dhe ruhet për një periudhë pa afat. Në përmbushje me detyrimet institucionale, informacioni i paraqitet palëve të interesuara në përputhje me normativat ligjore për ruajtjen e të dhënave personale. Institucioni disponon një databazë të plotë të të dhënave të studentëve, dhe përpunon të dhëna statistikore sipas kërkesave të institucioneve përgjegjëse apo nevojave të vetë institucionit.</p> <p><i>Aneksi Nr.19, Rregullore e Sekretarisë.</i>  <i>Aneksi Nr.20, Rregullore e arkives.</i>  <i>Aneksi Nr.79, Dokumentacioni që përmban dosja e studentitqe regjistrohet.</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>
--	------------------------------	-----------------------------	--

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<p><b>Standardi IV.1</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p> <p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në</p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p> <p>GVJ referuar dokumentacionit të dosjes së vlerësimit si dhe nga vizita në institucion, konstaton se Universiteti Metropolitan “Tirana”, ruan të dhëna të plota për stafin akademik si dhe atë ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ, të cilët janë të angazhuar në cdo vit</p>


Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 58

<p>program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësitor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>akademik dhe çdo semestër në programin e studimit Master i shkencave në Menaxhim në Inxhinieri.</p> <p>GVJ konstaton një tërësi dokumentash që argumentojnë përmbushjen e kriterit, si lista e stafit akademik, lëndët për çdo semestër, orët mësimore dhe ngarkesën totale, dosje personeli efektiv dhe me kontratë etj, të cilat disponohen nga departamenti përgjegjës, Departamenti i Informatikës Ekonomike si dhe zyra e burimeve njerëzore në institucion.</p> <p><i>Aneksi Nr.07, Rregullore e UMT.pdf</i>  <i>Aneksi Nr.08, Rregullore e FE-UMT.pdf;</i>  <i>Aneksi Nr.15, Lista e personelit akademik me kohe të plotë dhe me kohë të pjesshme në FE.pdf;</i>  <i>Aneksi Nr.22, Të dhëna statistikore të personelit akademik;</i>  <i>Aneksi Nr.25, Lista e lektorëve të huaj.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>GVJ mbështetur në dokumentacionin në dosjen e vetëvlerësimit, si dhe gjatë vizitës në institucion, konstaton se procedurat e rekrutimit të stafit akademik mbështeten në legjislacionin në fuqi, si dhe në statutin dhe rregulloren e institucionit.</p> <p><i>Personeli-Rregullore rekrutimi.pdf, vizita në institucion;</i>  <i>Aneksi Nr.66, Udhëzim mbi politikat e procedurat e punësimit të personelit akademik në UMT.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Referuar procedurës së rekrutimit të konsultuar gjatë vizitës në zyrën e Burimeve njerëzore, GVJ konstaton se Universiteti Metropolitan “Tirana”, harton kërkesa të përgjithshme, si dhe kritere preferenciale për stafin e programit.</p> <p>Nga vizita në institucion rezulton se kërkesat burojnë nga nevojat e njësisë përgjegjëse për staf akademik, ato përcillen në njësinë kryesore e në vijim në rektoratin e institucionit, së bashku me kriteret specifike, për lëndët, botimet etj.</p> <p>Referuar politikës së rekrutimeve, Universiteti Metropolitan “Tirana”, rezulton se institucioni publikon në faqen e internetit, thirrjet për punësim të stafit akademik efektiv dhe atyre me kohë të pjesshme, në të cilën deklarohet pozicioni vakant kriteret dhe procedura e përzgjedhjes.</p> <p><i>Aneksi Nr.66, Udhëzim mbi politikat e procedurat e punësimit të personelit akademik në UMT.pdf;</i>  <i>Personeli-Rregullore rekrutimi.pdf, vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të</p>	<p>Referuar procedurës së konsultuar të rekrutimit, GVJ konstaton se Universiteti Metropolitan “Tirana”, harton dhe zbaton procedura rekrutimi, të mbështetura në vlerësimin e aplikantëve në dy faza, atë</p>

përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit	të vlerësim dosjes dhe atë të intervistës. Vlerësimi i dosjes rezulton se bëhet nëpërmjet vlerësimit të kriterëve të përgjithëshme dhe specifike, nga komisioni i përbërë nga 5 anëtarë, me 3 përfaqësues të departamentit, 1 i dekanatit dhe 1 i rektoratit.  <i>Aneksi Nr 5.UMT_Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana; Procedure rekrutimi, vizita në institucion</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <tr> <td></td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<b>Standardi IV.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efëente dhe efektive</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Referuar RVB, dosjes së vlerësimit si dhe vizitës së ambienteve të Universitetit Metropolitan “Tirana”, GVJ konstaton se institucioni vendos në dispozicion të stafeve mjedise të përshtatshme, me kapacitet të pranueshëm, në përputhje me numrin e stafit për të krijuar kushte të përshtatshme për realizimin e aktivitëve në mënyrë profesionale.  <i>Aneksi Nr.21, Abjentet për Infrastrukturën FE-UMT.pdf</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Nga takimi me përfaqësues të institucionit dhe stafin akademik, rezulton se Universitetit Metropolitan “Tirana”, në saj të bashkëpunimeve që ka me Universitete dhe rrjete ndërkombëtare organizatash, mbështet, nxit dhe mundëson pjesëmarrjen e stafeve në aktivitete, trajnime, konferenca të organizuara nga këto rrjete dhe që i shërbejnë ngritjes shkencore të stafit akademik.  <i>Aneksi Nr.13, Lista e marreveshjeve me IAL-të nderkombetare dhe kombetare.pdf;</i> <i>Aneksi Nr.26 Lista e universiteteve bashkëpunuese në kuader të programit ERASMUS.pdf;</i> <i>Aneksi Nr.51, Lista e aktiviteteve shkencore.pdf</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm	GE konstatoi nga dokumentacioni në dosjen e vetëvlerësimit por edhe nga vizita në institucion, se Universiteti Metropolitan “Tirana”, mbështet plotësimin e nevojave të stafit, vlerëson nevojat për trajnim të stafeve për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 60

profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor. Në këtë kontekst institucioni rezulton se ka realizuar trajnime për metodat inovative të mësimdhënies, leksione të hapura me lektorë të huaj, ka nxitur pjesëmarrjen e stafit në trajnime të zhvilluara nga AKKSHI për aplikimin në projekte të kërkimit shkencor etj.		
	<p><i>Aneksi Nr.25, Lista e lektorëve të huaj.pdf;</i></p> <p><i>Aneksi Nr.80, Trajnim i stafit akademik nga projekti Bolonja Hub.pdf</i></p>		
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë	GVJ mbështetur në takimet me stafin akademik të programit Msc. Menaxhim në Inxhinieri, si dhe me GVB, vlerëson pozitivisht angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimit		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

### Standardi IV.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik e kërkimor, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	GVJ duke konsultuar dokumentacionin për infrastrukturën si dhe nga vizita në mjediset e Universitetit Metropolitan "Tirana", konstaton se Institucioni ka në dispozicion dy godina me sipërfaqe respektive, 2347 m <sup>2</sup> dhe 2490 m <sup>2</sup> . Mjediset janë mjedise të përshtatshme për zhvillimin e leksioneve/seminareve. Duke qenë se studentët e masterit e zhvillojnë mësimin në pasdite, rezulton se mjediset kanë një përdorim optimal dhe në përputhje me nevojat e studentëve të programit të studimit Msc. Menaxhim në Inxhinieri.
	<p><i>Aneksi Nr.21, Ambjentet për Infrastrukturën FE-UMT.pdf;</i></p> <p><i>Aneksi Nr.69, Relacion teknik per ambjentet dhe infrastrukturen e UMT.pdf.</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor	Nga RVB dhe nga vizita në institucion, sallat e leksioneve, seminareve, laboratorët janë të pajisura me pajisje audiovizive, PC, videoprojektor, internet wireless etj, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. Referuar

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 61

<p>teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>vizitës në institucion, gjenden 6 laboratorë informatikë, 6 salla leksionesh dhe 14 salla seminaresh e etj.</p> <p><i>Aneksi Nr.21, Ambjentet për Infrastrukturën FE-UMT.pdf;</i> <i>Aneksi Nr.69, Relacion teknik per ambjentet dhe infrastrukturen e UMT.pdf</i></p>		
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Sipas informacionit të siguruar nga dosja e vetëvlerësimit si dhe nga vizita në institucion, rezulton se laboratorët informatikë janë të pajisur me pajisjet hardwerike të duhura si dhe me softje specifike, në ndihmë të objektivave të programit Msc. Menaxhim në Inxhinieri.</p> <p><i>Aneksi Nr.21, Ambjentet për Infrastrukturën FE-UMT.pdf;</i> <i>Aneksi Nr.69, Relacion teknik per ambjentet dhe infrastrukturen e UMT.pdf</i></p>		
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Sic rezulton nga të dhënat infrastrukturale dhe nga vizita në institucion, institucioni vë në dispozicion të studentëve 6 laboratorë informatikë, të cilët rezultojnë në dispozicion edhe të studentëve të PS Msc. Menaxhim në Inxhinieri, sipas nevojave tëlëndëve tëndryshme.</p> <p><i>Aneksi Nr.21, Ambjentet për Infrastrukturën FE-UMT.pdf;</i> <i>Aneksi Nr.69, Relacion teknik per ambjentet dhe infrastrukturen e UMT.pdf</i></p>		
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike</p>	<p>Referuar vizitës në institucion si dhe RVB rezulton se studentët i zhvillojnë praktikat pranë institucioneve/kompanive të ndryshme. Nga dosja e vetëvlerësimit, konstatohet se Universiteti Metropolitan “Tirana”, disponon një tërësi marrëveshjesh me institucione të ndryshme, të cilat mbështesin dhe mundësojnë zhvillimin e praktikave profesionale, të studentëve të Msc. Menaxhim në Inxhinieri kryesisht në mjediset e tyre, si me sistemin bankar, Institutin e Ndërtimit, Gjeo Vjosa, KESH, disa banka të nivelit të dytë, te cilat u konsultuan në dokumentacionin e siguruar nga vizita në institucion.</p> <p><i>Aneksi Nr.28, Lista e marreveshjeve për zhvillimin e praktikave.pdf</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi IV.4**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e**

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë



E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 62

nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	GVJ gjatë vizitës në institucion, konstaton se UMT, vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore e cila është ka një fond librash, në gjuhë shqipe dhe të huaj, periodikë, revista shkencore etj.  <i>Nr.69, Relacion teknik per ambientet dhe infrastrukturen e UMT.pdf</i>
<b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Referuar RVB si dhe vizitës në institucion, biblioteka rezulton të këtë rreth 760 tituj, libra në gjuhë shqipe dhe të huaj, revista shkencore, literaturë bazë dhe ndihmëse sipas syllabuseve të lëndëve të programit të studimit Msc. Menaxhim në Inxhinieri.  <i>Nr.69, Relacion teknik per ambientet dhe infrastrukturen e UMT.pdf</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Nga RVB dhe nga takimet me studentët e programit, rezultojnë se ata kanë mundësinë e shfrytëzimit të bibliotekës, të fondit të saj fizik por ata kanë akses edhe në disa biblioteka elektronike, të shfrytëzueshme jo vetëm në mjediset e institucionit por edhe jashtë tij, nëpërmjet kredencialeve të studentëve.  <a href="http://www.doaj.org">www.doaj.org</a> <a href="http://www.cobis.org">www.cobis.org</a> <a href="http://www.gutenberg.org">www.gutenberg.org</a> etj.
<b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Biblioteka rezulton e pajisur me kompjutera me softere respektive për manaxhimin e bazës së të dhënave të bibliotekës si dhe me pajisje të tjera si fotokopje e pajisje skanuese. Hapësira fizike dhe kapacitet pritëse të bibliotekës konsiderohen të limituara nga GVJ. Edhe pse nje mjedis qe fton studenët dhe një klimë e mirë aktuale, GVJ do të sugjeronte shtimin e kapaciteteve fizike, posteve dhe pc-ve në bibliotekën e UMT, pavarësisht se institucioni ka nëplanet e veta zgjerimin e kapaciteteve nëkuadër tëinvestimit nëkampusin e ri tëinstitucionit nëtëardhmen.
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit	Nga takimi me drejtues të institucionit si dhe me GVB, rezulton se institucioni synon pasurimin e mëtejshëm të bibliotekës, nëpërmjet marrëveshjeve për përdorimin e fondeve të bibliotekave të instucioneve partnere apo shfrytëzimin e U-library në të ardhmen për të cilën është drejt finalizimit marrëveshja.

ekzistues në mbështetje të programit.	Për sa më sipër GVJ është e mendimit që UMT, të gjejë mekanizma të tjerë edhe për rritjen e financimit të mëtejshëm për një fond më të pasur fizik, si dhe për mjedise shfrytëzimi të bibliotekës me kapacitete me të mëdha, duke i praraprirë numrit të studentëve në rritje si dhe numrit me të lartë të programeve			
	<i>RVB; Vizita në institucion</i>			
<b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj	GVJ konstaton se biblioteka funksionon në orare në përshtatje me nevojën për shfrytëzim nga ana e studentëve të Msc. Menaxhim në Inxhinieri. Studentët kanë mundësi të shfrytëzojnë edhe bibliotekat elektronike, në të cilat UMT rezulton i regjistruar, duke rritur fleksibilitetin e përdorimit të bibliotekës si <a href="http://www.doaj.org">www.doaj.org</a> , <a href="http://www.cobis.org">www.cobis.org</a> , <a href="http://www.gutenberg.org">www.gutenberg.org</a>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet</b>
		X		

<b>Standardi IV.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	GVJ referuar rregullores së UMT, konstaton se të dhënat në UMT për programin e studimit Msc. Menaxhim në Inxhinieri, mbahen në dy forma, regjistrat manualë dhe regjistrat elektronik. Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi mbajtjen e regjistrave manual nga sekretaria mësimore në lidhje me studentët e programit. Përveç formave manuale, GVJ konstatoi një sistem informacioni funksional, që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në PS Msc. Menaxhim në Inxhinieri, i cili është pjesë e një sistemi të integruar informacioni në nivel institucional në UMT.
<b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Referuar takimit të zhvilluar me stafin e burimeve njerëzore, rezulton se zyra e burimeve njerëzore administron të dhënat dhe dokumentacionin për aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrative.



<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Referuar takimit me studentët e Msc. Menaxhim në Inxhinieri, rezulton se studentët nëpërmjet kredencialeve të tyre personale, kanë akses në informacionin në lidhje me progresin dhe vlerësimet e tyre në lëndët respektive, nëpërmjet sistemit të informacionit të integruar. GVJ nga RVB si dhe nga vizita në institucion, konstaton se sistemi i informacionit përqëndrohet në dy platforma, “edu4school” dhe “Gotomeeting”.</p> <p><i>Aneksi Nr.71, Manual i menaxhimit të sistemit informatik nga studentët.pdf;</i></p> <p><i>Aneksi Nr.81, Manual shpjegues i përdorimi të platformës edu4school.pdf;</i></p> <p><i>Aneksi Nr.11, Platformat per mesimin online.pdf; Aneksi Nr.60, Platformat GTM per mesimin online.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>GVJ vlerëson se sistemi i Manaxhimit të informacionit, “edu4schools” rezulton një platformë e cila ka të integruar 4 module, të cilat sigurojnë informacion dhe ju japin akses sekretarisë mësimore, studentëve, zyrës së menaxhimit financiar si dhe stafit akademik, duke ofruar shërbimin e informimit të tyre të ndërsjellë dhe të komunikimit të integruar.</p> <p>Nga takimet me studentët dhe stafin akademik, rezulton se përveç platformës “edu4schools”, në shërbim të tyre për zhvillimin e mësimin është edhe platforma “Gotomeeting”, që shërben për mësimdhënien online</p> <p><i>Aneksi Nr.11, Platformat per mesimin online.pdf;</i></p> <p><i>Aneksi Nr.59, Ndërfaqe classroom e një pedagogu.pdf;</i></p> <p><i>Aneksi Nr.60, Platformat GTM per mesimin online.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Sipas informacionit të siguruar gjatë takimeve me drejtues të njësisë kryesore dhe asaj bazë, rezulton se prej dy platformave gjenerohen raportime për drejtuesit, dhe mund të realizohen monitorime për procese të ndryshme, për zhvillimin e mësimin, për informimin e studentëve, duke i shërbyer vendimmarrësve për marrjen e vendimeve.</p> <p><i>Aneksi Nr.11, Platformat per mesimin online.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe</p>	<p>GVJ nga vizita e faqes zyrtare të institucionit, rezulton se aty publikohen informacione për stafin akademik, programet mësimore, kuotat, kriteret, aktivitetet, projektet etj në dy gjuhë, shqip dhe anglisht</p> <p><a href="https://umt.edu.al/en/about-mtu;">https://umt.edu.al/en/about-mtu;</a></p> <p><a href="https://umt.edu.al/en/research-and-projects;">https://umt.edu.al/en/research-and-projects;</a></p> <p><a href="https://umt.edu.al/programet-master">https://umt.edu.al/programet-master</a></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit” , Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 65

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

#### Standardi IV.6

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>GVJ konstaton se në zbatim të legjislacionit në fuqi, UMT harton një raport vjetor. Pjesë e këtij raporti rezultojnë të jetë edhe raportimi financiar i cili kalon nëpër të gjitha nivelet hierarkike, për njohje dhe sugjerime, për miratim final në bordin e Administrimit. Të ardhurat dhe shpenzimet, janë të detajuara sipas burimeve dhe sipas zërave të shpenzimeve.</p> <p>Referuar evidencës së konsultuar nga GVJ, rezultojnë se gjenden të detajuara të ardhurat nga tarifatat apo të ardhurat nga projektet, financimi nga administratori i UMT, si dhe shpenzimet sipas zërave të ndryshëm.</p> <p>Sipas RVB, institucioni deklaron se në fazën e aplikimit të hapjes së programit Msc Menaxhim në Inxhinieri, është paraqitur një raport i detajuar, mbi financimin, kostot për studentin si dhe planifikimi për ecurinë e programit.</p> <p><i>Aneksi Nr.29, Raport vjetor i aktivitetit mësimor, kërkimor dhe shkencor- FE Viti 2021-2022.pdf;</i>  <i>Aneksi Nr.82, Të ardhura në 5 vitet e fundit në UMT.pdf;</i>  <i>Aneksi Nr.83, Auditimi i Pasqyrave Financiare.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion</p>	<p>Pavarësisht se GVJ nuk konstatoi planin financiar në nivelin e programit, referuar vizitës në UMT dhe nga RVB, konstaton se buxheti pavarësisht se paraqitet në nivelin e institucionit në formën e tij finale, mënyra e hartimit të tij, përfshin disa nivele, nga poshtë-lart, duke nisur propozimet nga departamenti, të cilat paraqesin kërkesat buxhetore për financim, nisur nga kërkesat për të mbështetur cdo program studimi, për burime njerëzore, për shpenzime operative, për teknologjitë, shpenzimet për bibliotekën etj.</p> <p>Në vijim buxheti planifikohet në nivelin e njësisë kryesore, zyra e financës sintetizon buxhetin për të gjithë zërat në nivelin e institucionit dhe ia paraqet Senatit, i cili bën miratimin paraprak, për të vijuar miratimin nga Bordi i Administrimit të UMT.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 66

të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Nga RVB dhe takimi me GVB, rezultojnë se institucioni kryen auditime të përvitshme, të pavaruara nga kompani auditimi, por gjithashtu nga strukturat e UMT, ku zbatimi i buxhetit dhe pozicioni financiar i UMT është detyrë funksionale e zyrës së financës në UMT, në përputhje me rregulloren e institucionit.</p> <p>GVJ për këtë kriter i referohet RVB, si dhe të dhëna për të ardhurat dhe shpenzimet që institucioni ka depozituar në dosjen e vlerësimit të brendshëm si dhe raportit të auditimit që gjenden në dosjen e vetëvlerësimit.</p> <p><i>Aneksi Nr.29, Raport vjetor i aktiviteti mësimor, kërkimor dhe shkencor- FE Viti 2021-2022.pdf;</i>  <i>Aneksi Nr.82, Të ardhura në 5 vitet e fundit në UMT.pdf</i>  <i>Aneksi Nr.83, Auditimi i Pasqyrave Financiare.pdf;</i></p>		
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Referuar RVB si dhe raporteve vjetore në DVV, rezultojnë se është përcjellë informacion për të ardhurat dhe shpenzimet, në mënyrë analitike sipas zërave.</p> <p>Këto të dhëna, janë në nivel institucional dhe paraqiten në mënyrë sintetike.</p> <p><i>Raport vjetor i aktiviteti mësimor, kërkimor dhe shkencor- FE Viti 2021-2022.pdf;</i>  <i>Aneksi Nr.82, Të ardhura në 5 vitet e fundit në UMT.pdf</i></p>		
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen</p>	<p>Rezultojnë se UMT, ka një strukturë të posaçme për manaxhimin financiar sic dëshmohet nëpërmjet RVB. Këto struktura auditohen nga auditime të pavarura të certifikuara, të cilat dëshmojnë për qëndrueshmërinë financiare të institucionit, në mënyrë të përvitshme.</p> <p><i>Aneksi Nr.29, Raport vjetor i aktiviteti mësimor, kërkimor dhe shkencor- FE Viti 2021-2022.pdf;</i>  <i>Aneksi Nr.82, Të ardhura në 5 vitet e fundit në UMT.pdf</i>  <i>Aneksi Nr.83, Auditimi i Pasqyrave Financiare.pdf;</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>		<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>GVJ referuar dokumentacionit në dosjen e vetëvlerësimit si dhe nga informacioni i siguruar në institucion, konstaton se UMT disponon politika dhe procedura për pranimin. Përzgjedhjen, transferimin e studentëve. GVJ është e mendimit se këto politika dhe procedura janë në përputhje me bazën ligjore rregullative.</p> <p>GVJ konstaton se UMT ka një sërë rregulloresh dhe procedurash, duke filluar nga niveli institucional në tërësi e deri tek departamenti apo programi i studimit që mbulojnë një cikël të plotë nga hyrja deri në diplomim, të studentëve në PS Msc. Menaxhim në Inxhinieri.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Orientimi dhe këshillimi i studentëve është i sanksionuar në dokumentat strategjik të institucionit</p> <p>Ky informim nis nga momenti i informimit për programet akademike, para fillimit të çdo viti, nëpërmjet web sitit të UMT ku gjenden të publikuara, programet, planet mësimore si dhe kuotat e kriteret</p> <p>GVJ referuar evidencave si dhe informacionit gjatë takimit me studentët e PS Msc. Menaxhim në Inxhinieri, është e mendimit se aktet rregullatore ku sanksionohen politikat dhe procedurat që ndiqen nga hyrja në dalje e studentëve, ofrojnë trajtimin e drejtë dhe të barabartë të studentëve mbështetur mbi meritokracinë. Referuar këtu politikave të pranimit, atyre të frekuentimit, të ankimimit si dhe të vlerësimit të arritjeve akademike të studentëve, orientohen drejt garantimit të barazisë, paanshmërisë dhe transparencës dhe zbatimit të udhëzimeve dhe akteve nënligjore</p> <p><i>Aneksi Nr.05, Statuti i UMT.pdf;</i>  <i>Aneksi Nr.07, Rregullore e UMT.pdf</i>  <i>Aneksi Nr.44, Kriteret e pranimit në programet studimore të FE.pdf</i>  <i>Aneksi Nr.84, Procedurat për aplikim dhe transferimit në programet e UMT.pdf,</i></p>

	<i>Aneksi Nr.85, Koutat e Pranimet në FE të UMT për vitin akademik 2022-2023.pdf;</i>		
<b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	GVJ është e mendimit se procedurat që UMT disponon për pranimet, transferimet për vlerësimin e dijeve apo për diplomimin, janë procedura të cilat janë transparente, të aksesueshme dhe të kuptueshme nga palët e interesuara.  <i>Aneksi Nr.86, Rregullore e bursave në UMT.pdf;</i> <i>Aneksi Nr.87, Raport i MASR mbi certifikimin e kuotave të pranimit në UMT.pdf</i>		
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.	Referuar RVB si dhe dosjes së vetëvlerësimit, webit të fakultetit dhe takimeve me drejtues të institucionit, rezulton se kuotat për Msc. Ekonomik në MBA, propozohen nga njësia bazë dhe miratohen nga senati. Kuotat dhe kriteret gjenden të publikuara në faqen zyrtare të UMT. Referuar kriterëve, rezulton se nuk ka kritere të veçanta, përveç atyre që parashikohen në aktet ligjore të MAS.  <i>Aneksi Nr.44, Kriteret e pranimit në programet studimore të FE.pdf;</i> <a href="https://umt.edu.al/pranimet-ne-programet-master">https://umt.edu.al/pranimet-ne-programet-master</a>		
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit	Përveç publikimet në faqen zyrtare të UMT, ku konstatohet informacion i plotë për kuotat, kriteret dhe procedurën e aplikimit edhe strukturat e institucionit, njësia kryesore dhe njësia bazë si dhe zyra e pranimit në UMT, rezulton se informojnë dhe udhëzojnë studentët e interesuar. Këto orientime përcillen edhe nëpërmjet guidës së studentit, nëpërmjet panairëve të studimit etj.  <a href="https://umt.edu.al/pranimet-ne-programet-master">https://umt.edu.al/pranimet-ne-programet-master;</a> <i>Aneksi Nr.35, Guida e studentit.pdf</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

### Standardi V.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit	GVJ konstaton nga takimet me studentët e programit si dhe nga dosja e vetëvlerësimit se strukturat e UMT, ofrojnë informacion të plotë rreth kriterëve për të kaluar nga një vit në tjetrin. Studentët rezultojnë

<p>akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>se informohen për detyrimet lëndore apo kriteret e frekuentimit nga stafi akademik i programit, në fillim të cdo semestri. Këto detyrime janë të sanksionuara ne rregulloren e institucionit dhe të njësisë kryesore.</p> <p><i>Aneksi Nr.07, Rregullore e UMT.pdf;</i>  <i>Aneksi Nr.08, Rregullore e FE-UMT.pdf;</i>  <i>Aneksi Nr.09, Rregullore e programit të studimit në "MSc" në Menaxhim në Inxhinieri.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Në informacionet e publikuara për studentët rezultojnë edhe procedurat e transferimeve të studimeve si dhe të kërkesave që duhet të plotësohen, sic janë detyrimet e njohjes së gjuhës së huaj, për të cilat studentët rezultojnë të informuar.</p> <p><i>Aneksi Nr.35, Guida e studentit.pdf;</i>  <i>Aneksi Nr.45, Procedure aplikimi, regjistrimi dhe transferimi.pdf</i>  <i>Aneksi Nr.84, Procedurat për aplikim dhe transferimit në programet e UMT.pdf;</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Nga takimi me studentët e programit, stafin akademik si dhe përfaqësues së zyrës së këshillimit të studentëve, rezulton se studentët informohen cdo fillim semestri prej pedagogëve të lëndëve, për procedurat e vlerësimit të dijeve. Këtij qëllimi i shërbejnë edhe javët orientuese që institucioni mban, për të orientuar studentët që synojnë të regjistrohen në këto programe, apo që tashmë janë regjistruar.</p> <p><i>Aneksi Nr.35, Guida e studentit.pdf;</i>  <i>Aneksi Nr.75, Model i syllabusit.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Në kuadër të informimit të plotë të studentëve dhe orientimit të tyre, rezulton se njësia bazë informon studentët për kriteret dhe metodologjinë e përgatitjes së punimit të mikrotezës. Studentëve iu vihet në dispozicion udhëzuesi i diplomës, ndjekjen e zbatimit të së cilit e realizojnë udhëheqsit e diplomës.</p> <p><i>Aneksi Nr.73, Plan pune për punimin e diplomës-Msc ne Menaxhim ne Inxhinieri.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</p>	<p>Nga takimi me përfaqësues së zyrës e karrierës, UMT orienton studentët potencial, nëpërmjet komunikimit të drejtëpërdrejtë me ta si dhe organizimit të javës orientuese. Gjithashtu një instrument tjetër informimi orientimi në kohë reale, institucioni përdor edhe rrjetet sociale si dhe web sitin e institucionit.</p>

	<i>Aneksi Nr.35, Guida e studentit.pdf</i> <i>Aneksi Nr.79, Dokumentacioni që përmban dosja e studentitqë regjistrohet.pdf;</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

### Standardi V.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Gvj nga vizita në institucion si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit, konstaton se UMT nëpërmjet organizimit të javëve orientuese, takimeve të drejtuesve me studentët, i orienton ata për kohëzgjatjen e studimeve, për strukturën e programit, për organizimin dhe zhvillimin e tij, etj  <i>Aneksi Nr.18, Plan programet e lëndëve syllabuset.pdf</i> <i>Aneksi Nr.39, Plani mësimor 2022-2023 për programin Msc në Menaxhim ne Inxhinieri.pdf;</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Takimet me studentët dëshmuar se ata janë të informuar rreth lëndëve, moduleve, formave të vlerësimit, detyrimeve lëndore. Këto informacione jepen kryesisht nga pedagogët në seancën e parë të zhvillimit të semestrit. Studentët nëpërmjet sistemit “edu4schools”, marrin informacion në kohë reale për modulet, lëndët dhe cdo informacion rreth dosjes së programit Msc. Menaxhim në Inxhinieri.  <i>Aneksi Nr.35, Guida e studentit.pdf</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Nga dosja e vetëvlerësimit si dhe nga takimet në institucion, rezulton se strukturat e njësisë kryesore dhe të njësisë bazë, por edhe zyra e karrierës, informojnë studentët e Msc. Menaxhim në Inxhinieri, rreth mundësive të intershipit apo të punësimit dhe orientimit për zhvillimin e karrierës.  <i>Aneksi Nr.90, Mbi funksionimin e Zyres se Keshillimit te Karrjeres.pdf</i>
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën,	Javët e informimit, rezultojnë se janë orientuese për t'i aklimatizuar studentët me mjedisin e UMT. Nëpërmjet sekretarisë, departamentit, si dhe nëpërmjet web sitit e guidës së studentit, studentët informohen për organizimin e procesit mësimor, orarit, sallave/laboratorëve etj.

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 71

infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	<i>Aneksi Nr.35, Guida e studentit.pdf;</i> <i>Aneksi Nr.46, Orari mësimor i programeneve Msc Semestri i parë 2022-2023.pdf</i>		
<b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Përvec aktiviteve informuese sic janë javët orientuese si dhe informacionit verbal, studentët rezultojnë se përdorin aktivisht platformën edu4schools, për të marrë informacion rreth syllabuseve, leksioneve, detyrimeve lëndore, rezultatet e provimeve etj.  <i>Aneksi Nr.11, Platformat per mesimin online.pdf;</i> <i>Aneksi Nr.59, Ndërfaqe classroom e një pedagogu.pdf;</i> <i>Aneksi Nr.60, Platformat GTM per mesimin online.pdf</i>		
<b>Kriteri 6.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve	Referuar DVV si dhe vizitës në institucion, rezulton se edu4schools, është një sistem i brendshëm informacioni, që integron dhe administron informacionin e sekretarisë, të stafit akademik si dhe të zyrës së financës.  <i>Aneksi Nr.81, Manual shpjegues i përdorimi të platformës edu4school.pdf</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

#### Standardi V.4

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.	GVJ gjatë vizitës në UMT si dhe takimeve me përfaqësues të sekretarisë mësimore, konstaton se UMT, disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për PS Msc. në Menaxhim në Inxhinieri. Sipas informacionit të siguruar përvec regjistrave të institucionit, që GVJ konsultoi, këto informacione ruhen edhe në mënyrë elektronike në platformën “edu4scholls”.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me	GVJ konsultoi regjistrat themeltar për Msc. në Menaxhim në Inxhinieri, të cilët kanë të regjistruarit e cdo viti, studentët e larguar apo të tërhequr si dhe të diplomuarit e cdo viti.



<p>sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit.</p>	<p>Numri i studentëve të regjistruar për herë të parë, për vitin akademik:</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- 2020-2021 12 studentë</li> <li>- 2021-2022 5 studentë</li> <li>- 2022-2023 12 studentë</li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Numri i studentëve të diplomuar</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 2019-2020 7 student</li> <li>- 2020-2021 12 studentë</li> <li>- 2021-2022 8 studentë</li> <li>- 2022-2023 nëproces</li> </ul>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve</p>	<p>GVJ konsultoi proceverbale të lëndëve, vlerësimet e studentëve për lëndë të ndryshme, si dhe regjistrat e notave dhe konstatoi përputhshmëri mes formave të vlerësimit në syllabus si dhe regjistrave të notave. Nga takimi me studentët rezultoi se studentët për vlerësimet e tyre informohen nëpërmjet sistemit informatik, “edu4scholls”, në të cilin pedagogët hedhin vlerësimet e lëndës, ku cdo përdorues aksesohet nëpërmjet kredencialeve individuale.</p> <p>UMT disponon të dhëna për ecurinë e studentëve, gjatë zhvillimit të programit të studimit, Msc Menaxhim në Inxhinieri, që nga pranimi (mesataren në hyrje), deri në diplomimin e tyre dhe rezultoni se i analizon ato në analizat vjetore, për identifikuar ndryshimet në cilësinë e aplikimeve dhe pranimeve.</p> <p>Rezultoni se mesatarja në hyrje rezultoni:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 2019-2020 7.53</li> <li>- 2020-2021 6.33</li> <li>- 2021-2022 7.48</li> <li>- 2022-2023 nëproces</li> </ul> <p>Rezultoni se mesatarja në dalje rezultoni:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 2017-2018 6.03</li> <li>- 2018-2019 7.06</li> <li>- 2019-2020 8.11</li> </ul> <p>GVJ gjatë vizitës në institucion, konsultoi regjistrat themeltar ku çdo student, është regjistruar dhe ishte pajisur me numër matricullimi.</p> <p>Gjithashtu GVJ konsultoi dosje të studentëve të regjistruar, të cilat përmbanin dokumentacionin e duhur dhe të noterizuar, si diploma e bachelorit, listë notash, fotokopje e kartës së identitetit, dëshmi e gjuhës së huaj etj</p> <p><i>Evidenca Tabelat Permbledhese.pdf;</i>  <i>Aneksi Nr.19, Rregullore e Sekretarisë.pdf;</i></p>

	<i>Aneksi Nr.79, Dokumentacioni që përmban dosja e studentitqë regjistrohët.pdf</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi V.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Referuar vizitës në institucion si dhe takimeve me drejtues të njësisë kryesore, asaj bazë si dhe me studentë të programit Msc. Menaxhim në Inxhinieri, UMT në aktet e brendshme rregullatore, Statut, Rregullore dhe Rregullore e Senatit Studentor, parashikon përfshirjen e studentëve në organe vendimmarrëse, si senat, NJSBC, komisione ad-hoc etj.  <i>Aneksi Nr.05, Statuti i UMT.pdf;</i> <i>Aneksi Nr.07, Rregullore e UMT.pdf;</i> <i>Aneksi Nr.89, Rregullore e Këshillit Studentor të UMT.pdf</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Nga informacioni i siguruar nga DVV dhe nga takimet me drejtues, staf dhe studentët e programit Msc. Menaxhim në Inxhinieri, GVJ është e mendimit se UMT, nxit dhe garanton përfshirjen e studentëve, në organe vendimmarrëse si senati akademik, përfshirje në NJSBC dhe në komisione ad-hoc. Gjithashtu nëpërmjet pyetësorëve, studentët përcjellin në organet vendimmarrëse perceptimin e tyre, rreth proceseve mësimore dhe atyre vlerësuese.  <i>Aneksi Nr.52, Aktivitete të kryera nga studentët-qeveri studentore UMT-FE.pdf;</i> <i>Aneksi Nr.74, Përbërja e Njësise së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë-2022.pdf</i>
<b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të	GVJ është e mendimit se UMT në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, Msc. Menaxhim në Inxhinieri, mban parasysh ngarkesën akademike të studentëve dhe se disponon procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.

studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	<i>Aneksi Nr.47, Udhezim mbi Vlerësimin dhe transferimin e studimeve në UMT.pdf</i>		
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.	Sic rezultoi nga takimi që GVJ pati me përfaqësues të studentëve dhe të NJSBC, institucioni organizon dy herë në vit, pyetësorë për studentët për të siguruar informacion dhe sugjerime prej tyre rreth, ecurisë së programit të studimit.  <i>Aneksi Nr.48, Model i pyetësorit të studentit per lendenpedagogun.pdf; Aneksi Nr.49, Analiza e NJSBC për pyetësorët S1-2021-2022.pdf</i>		
<b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës	GVJ konstaton se studentët kanë të sanksionuar në rregullore, të drejtën e ankimimit si dhe të drejtën e rishikimit të rezultateve të vlerësimit të tyre  Referuar takimeve me stafin akademik dhe me studentët e PS Msc. Menaxhim në Inxhinieri, rezulton se ata kanë të drejtën e ankimimit të rezultatit dhe konsultimit me tezën e provimit për tu qartësuar për vlerësimin e tyre.  Gjithashtu nëpërmjet anketimeve semestrale, studentët kanë të drejtë të shprehin perceptimet e tyre, mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve.  <i>Aneksi Nr.37, Rregullore e provimeve.pdf</i> <i>Aneksi Nr.48, Model i pyetësorit të studentit per lendenpedagogun.pdf;</i> <i>Aneksi Nr.49, Analiza e NJSBC për pyetësorët S1-2021-2022.pdf</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

#### Standardi V.6

**Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.	Referuar takimeve me stafin akademik të programit dhe dokumentacionit në dosjen e vetëvlerësimit, rezulton se stafi akademik i njësisë bazë përgjegjëse për Msc. Menaxhim në Inxhinieri, merr pjesë në konferenca shkencore kombëtare dhe

	<p>ndërkombëtare. Stafit akademik është aplikues dhe fitues në projekte të karakterit. Në kuadër të tij nga vizita në institucion rezultojnë se janë kryer një tërësi aktivitetesh nga stafit i departamentit dhe i programit të studimit, si webinarë, leksione të hapura për sipërmarrjet sociale, ku rezultojnë 6 pedagoge të perfshirë</p> <p><i>Aneksi Nr.30, Lista e projekteve të aplikuara dhe të fituara nga UMT.pdf;</i>  <i>Aneksi Nr.32, Plani Vjetor i Punës në FE për vitin 2022- 2023.pdf;</i>  <i>Aneksi Nr.33,Raporti mbi aktivitetin kërkimor-shkencor të stafit akademik të FE.pdf; A</i>  <i>neksi Nr.34, Lista e botimeve.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.</p>	<p>Nga dokumentacioni në dosjen e vetëvlerësimit, rezulton se UMT disponon një tërësi marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione të huaja dhe vendase në kuadër të bashkëpunimit, për studime, konferenca të përbashkëta dhe projekte të përbashkëta. Nder këto universitete rezultojnë universitete në Itali, Kinë, Francë, Maqedoni, Hungari, Lituani, Rumania etj.</p> <p><i>Aneksi Nr.30, Lista e projekteve të aplikuara dhe të fituara nga UMT.pdf;</i>  <i>Aneksi Nr.26 Lista e universiteteve bashkëpunuese në kuadër të programit ERASMUS.pdf;</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore.</p>	<p><i>Aneksi Nr.30, Lista e projekteve të aplikuara dhe të fituara nga UMT.pdf;</i>  <i>Aneksi Nr.26 Lista e universiteteve bashkëpunuese në kuadër të programit ERASMUS.pdf;</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.</p>	<p><i>Aneksi Nr.13, Lista e marreveshjeve me IAL-të nderkombetare dhe kombetare.pdf</i></p> <p>Nga takimet me stafin dhe studentët e programit, rezulton se institucioni nxit studentët të përfshihen në projekte dhe në publikime në bashkëpunim me stafin akademik të programit. Studentët nxiten të bëhen pjesë e konkurseve që zhvillohen, ku prezantojnë projektet e tyre. Për studentët ekselentë parashikohen edhe politika motivuese si bursëmerite.</p> <p>Publikimet në revista shkencore ndërkombëtare, janë kusht jo vetëm për promovimin akademik të stafit, por rezulton se institucioni nxit dhe promovon përfshirjen e stafëve në konferenca shkencore si dhe të botimeve shkencore cilësore. Nga vizita në institucion rezulton se institucioni ka edhe revisitë shkencore organ i UMT, në të cilën politika e botimit rezulton favorizuese për stafet, duke qenë se parashikon tarifa botimi lehtësisht të përballueshme.</p> <p><i>Aneksi Nr.33, Raporti mbi aktivitetin kërkimor-shkencor të stafit akademik të FE.pdf;</i>  <i>Aneksi Nr.34, Lista e botimeve.pdf;</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.</p>	<p><i>Aneksi Nr.51, Lista e aktiviteteve shkencore.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për</p>	<p>Udhëheqja dhe asistenca e stafit akademik për përgatitjen dhe realizimin e diplomës janë të sanksionuara në rregullore. Nga takimet</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit" , Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 76

kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës	me stafin dhe studentët, konstatohet se stafi mbështet, orienton dhe udhëheq studentët drejt përbushjes së detyrimeve që kërkon realizimi i temës së diplomës. <i>Aneksi Nr.40. Procedurat e përgatitjes dhe mbrojtjes së diplomës-MSc-MI.pdf;</i> <i>Aneksi Nr.56, Lista e temave per mbojtte diplome.pdf;</i> <i>Aneksi Nr.73, Plan pune për punimin e diplomës-Msc ne Menaxhim ne Inxhinieri.pdf</i>		
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi V.7</b>	
<b>Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit.	GVJ konstaton se UMT, ka nënshkruar një tërësi marrëveshjesh bashkëpunimi që synojnë të nxisin përfshirjen e stafit akademik në kërkime shkencore të përbashkëta, si dhe në mobilitete për stafin akademik. GVJ gjate vizitës ne institucion dhe takimeve me përfaqësues te zyrës se projekteve, konstatoi se pedagogët e programit të studimit, kane aplikuar dhe përfituar nga programet e shkëmbimit te stafit akademik, ne kuadër te programit Erasmus+, ne rruge institucionale.  <i>Aneksi Nr.13, Lista e marreveshjeve me IAL-të nderkombetare dhe kombetare.pdf;</i> <i>Aneksi Nr.26 Lista e universiteteve bashkëpunuese në kuader të programit ERASMUS.pdf;</i> <i>Aneksi Nr.30, Lista e projekteve te aplikuarra dhe të fituara nga UMT.pdf;</i> <i>Aneksi Nr.67, Udhëzues për planin e mobilitetit për stafin akademik ne kuader te erasmus.pdf</i>
<b>Kriteri 2.</b> Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.	Referuar informacionit të siguruar gjatë takimeve me studentët dhe stafin akademik të programit, rezulton se stafi akademik i programit përdor metoda inovative dhe nxit studentët drejt hulumtimeve dhe kërkimeve sekondare e primare, duke i shërbyer parapërgatitjes së tyre për të studimet e ciklit të tretë.  <i>Aneksi Nr.75, Model i syllabusit.pdf</i>

<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.</p>	<p>GVJ konstaton se UMT nxit përfshirjen e studentëve të masterit shkencor, por edhe të studiuesve të rinj, pjesë e stafit akademik në projekte kërkimore, që dëshmojnë nga informacioni në dosjen e e vetëvlerësimit, për projektet ku UMT ka aplikuar. Rezulton se për studiuesit e rinj, institucioni aplikon edhe politika të mbështetjes financiare.</p> <p><i>Arkivi-Riorganizimi i aktivitetit të kërkimit shkencor R&amp;D.pdf;</i>  <i>24.UMT_Lista e projekteve të aplikuara nga UMT dhe projektet fituese.pdf;</i>  <i>Personeli-Mbështetje financiare staf.pdf</i></p>		
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe nga DVV, GVJ konstaton se UMT në kuadër të marrëveshjeve që ka dhe bashkëpunimeve me universitete të huaja, ka ftuar lektorë kërkues të huaj, gjithashtu kjo demonstron edhe me mbulimin e disa lëndëve në planin mësimor të Ps, Msc. Menaxhim në Inxhinieri, të lektorëve të huaj, që mbulojnë lëndë të tilla si Strategji Marketingu dhe Manaxhim i Cilesisë.</p> <p><i>Tabelat Shqip.pdf;</i>  <i>Aneksi Nr.25, Lista e lektorëve të huaj.pdf</i>  <i>Aneksi Nr.26 Lista e universiteteve bashkëpunuese në kuadër të programit ERASMUS.pdf;</i></p>		
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.</p>	<p>Institucioni rezulton se nxit përfshirjen e studentëve për të përfutur mobilitete në universitete të huaja. Studentët mbështeten, orientohen nga zyrat mbështetëse që të aplikojnë për të përfutur nga mobilitetet e projekteve Erasmus. GVJ vlerëson punën e këtyre strukturave.</p>		
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore</p>	<p>Në UMT rezulton se institucioni fton lektorë të huaj që kanë mbajtur leksione të hapura për studentët dhe stafin e ri, si dhe lektorë të huaj të cilët në programin Msc. Menaxhim në Inxhinieri, mbulojnë lëndë të caktuara sic është Strategji Marketingu dhe Manaxhim i Cilesisë.</p> <p><i>Tabelat Shqip.pdf;</i>  <i>Aneksi Nr.25, Lista e lektorëve të huaj.pdf</i>  <i>Aneksi Nr.26 Lista e universiteteve bashkëpunuese në kuadër të programit ERASMUS.pdf;</i>  <i>Aneksi Nr.27, Lista e shkëmbimeve të studentëve në kuadër të Programit ERASMUS.pdf;</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<b>X</b>

**Standardi V.8**

**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Nga vizita në institucion si dhe nga struktura organizative e UMT, GVJ konstaton se UMT ka procedura dhe njësi të posaçme në strukturën organizative që kanë në fokus shërbimin e informimit të studentëve, që në fazën e hyrjes deri në diplomim. Këto shërbime ofrohen kryesisht nga zyra e karrierës. Format e informimit janë të ndryshme, nëpërmjet rregulloreve, guidës, fletëpalosjeve, komunikimit verbal, komunikimit elektronik nëpërmjet sistemit edu4schools etj.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p><i>Aneksi 35. Guida e studentit.pdf</i> GVJ konstaton se UMT ka funksional sistemin për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre, për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe PS Msc. Menaxhim në Inxhinieri.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Ky sistem mbështetet edhe nga informimi në rrjetet sociale të studentëve, si kanale të komunikimit efektiv me studentët Faqja zyrtare e UMT, është një tjetër mundësi nëpërmjet të cilës studentët mund të sigurojnë informacion për programet, lëndët, kriteret, kuotat, oraret, mobilitetet, transferimet etj Nga takimi me përfaqësues të sekretarisë dhe zyrës së karrierës dhe të studentëve, rezultojnë se kjo zyrë, asiston studentët dhe këshillon ata për ecurinë e karrierës së tyre, duke i orientuar drejt mundësive të punësimit, apo për oportunitetet e zgjedhjes dhe zhvillimit të praktikës profesionale, pranë kompanive, më të cilat UMT ka marrëveshje dhe që konsiderohen aktive, si dhe për trajnimet e ndryshme për studentët</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse</p>	<p>Referuar DVV si dhe takimeve përfaqësues të zyrës, institucioni nëpërmjet zyrës së këshillimit të karrierës, kryesisht, ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit, nëpërmjet pyetësorit të Alumnit, duke azhurnuar të dhënat me të diplomuarit si dhe më punësimin e tyre. Në vijim institucioni, përgatit statistika për punësimin e studentëve për organet drejtuese për vendimmarrje të ndryshme të tyre. <i>Aneksi Nr.14, Rrjeti Alumni UMT.pdf</i></p>
	<p style="text-align: right;">Përbushet kryesisht</p>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>				X
--	--	--	--	---

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>			<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	GVJ referuar DVV si dhe takimeve në institucion, konstaton se UMT ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel institucioni.  Përgjegjësi të e NJSBC, janë sanksionuar në statutin dhe rregulloren e UMT. Kjo njësi përgjegjëse për monitorimin e cilësisë, ka në përbërjen e vetë anëtarë nga njësitë kryesore të UMT si dhe një ekspert të jashtëm.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentë dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	<i>Aneksi Nr.05, Statuti i UMT.pdf;</i> <i>Aneksi Nr.62, Rregullorja e NJSBC.pdf</i> <i>Aneksi Nr.74, Përbërja e Njësise së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë-2022.pdf;</i> <i>Aneksi Nr.63, Aktet e akreditimit dhe riakreditimit institucional në UMT.pdf;</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	NJSBC në UMT, referuar takimeve në institucion, operon duke përdorur disa mekanizma dhe duke integruar rezultatet që këto mekanizma sigurojnë. NJSBC organizon takime studentët e programit, pyetësorë dhe sondazhe me studentët. GVJ vlerëson pozitivisht praktikën e ndjekur nga institucioni për përfshirjen jo vetëm të aktorëve të brendshëm, por edhe të ekspertëve të jashtëm për përmirësimin e cilësisë.  <i>Aneksi Nr.49, Analiza e NJSBC për pyetësorët S1-2021-2022.pdf;</i> <i>Aneksi Nr.48, Model i pyetësorit të studentit per lendenpedagogun.pdf</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 80



**Kriteri 4.** Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjve përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit

Nga dosja e vetëvlerësimit konstaton se UMT është akredituar në vitin 2017 institucionalisht, në 2019 po ashtu duke qenë se është riorganizuar duke shtuar një njësi kryesore dhe duke u orientuar drejt përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.

*Aneksi Nr.63, Aktet e akreditimit dhe riakreditimit institucional në UMT.pdf*

Nga takimi me drejtues të njësisë kryesore dhe asaj bazë, rezultoi se përveç NJSBC, njëtërësi mekanizmesh të sigurimit të cilësisë përdoren edhe nga njësia bazë përgjegjëse për programin Msc. Menaxhim në Inxhinieri.

Njësia bazë rezulton se:

Nëpërmjet komisioneve ad hoc zhvillon monitorime dhe vlerësime të proceseve akademike të stafëve.

Përgjegjësi i departamentit, në përfundim të cdo viti akademik, bën vlerësimin e performancës, për aktivitetet mësimore, atë kerkimore shkencore si dhe kontributin institucional

Titullarët e lëndëve bëjnë vlerësimin e performancës për stafet me kontratë, të cilat shërbejnë si bazë për rilidhjen e kontratës.

GVJ konstaton nga takimi me studentët, drejtuesit, stafin akademik si dhe përfaqësues të NJSBC, përdor mekanizma të ndryshëm që synojnë vlerësim të cilësisë së programit të studime.

Përveç pyetësorëve, takimeve, kontrolleve nga departamentet realizohen nga njësia bazë edhe kontrolli i provimeve dhe syllabuseve me qëllim që të monitorohen proceset e ndryshme.

Rezulton se institucioni përveç mekanizmave të vlerësimit të brendshëm, i nënshtrohet vlerësimit të jashtëm periodik programor dhe rezulton se ndërmer plan masash, për zbatim të rekomandimeve duke i shërbyer përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë.

*Personeli-Vleresim performance.pdf*

*Aneksi Nr.49, Analiza e NJSBC për pyetësorët S1-2021-2022.pdf*

Për sa më sipër GVJ konsultoi formate pyetësorësh, plane masash për zbatim rekomandimesh, në DVV si dhe nga infomacioni i siguruar gjatë vizitës në institucion.

*Aneksi Nr.48, Model i pyetësorit të studentit per lendenpedagogun.pdf*

	GVJ konstaton që NJSBC ka një regullorë të operimit të saj dhe ka një tërësi mekanizmash dhe procedurash të integruara duke synuar kështu krijimin e një kulture cilësie me përfshirjen e të gjithë aktorëve, staf akademik, administrativ, studentë, drejtues, përfshirë edhe ekspertë të jashtëm. <i>Aneksi Nr.62, Rregullorja e NJSBC.pdf</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi VI.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngrre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë.	Nga dokumentacioni në dosjen e vetëvlerësimit, rezulton se NJSBC në nivel institucioni është krijuar në 2019, ka në përbërje të saj 6 anëtare, mes të cilëve një student, një ekspert të jashtëm për çështjet e cilësisë, përfaqësues nga cdo fakultet si dhe nga administrata. NJSBC në nivel institucioni, funksionon mbi regulloren e miratuar.  <i>Aneksi Nr.62, Rregullorja e NJSBC.pdf</i> <i>Aneksi Nr.74, Përbërja e Njësise së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë-2022.pdf.</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit të ciklit të dytë.	Referuar RVB, takimeve me NJSBC, stafin dhe studentët rezulton se UMT përdor mekanizma formale për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e programit. Rezulton se nga NJSBC, zhvillohen pyetësorë para përfundimit të cdo semestri. Njësia kryesore dhe ajo bazë rezultojnë të zhvillojnë procese monitorimi, sipas një plani monitorimi. Planet mësimore dhe syllabuset, ndryshohen për të siguruar përputhshmërinë me bazën ligjore por edhe për tu përmirësuar.  <i>Aneksi Nr.62, Rregullorja e NJSBC.pdf;</i> <i>Aneksi Nr.64, Raport monitorimi javor dhe progresiv për mësimdhënien.pdf</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.	Metodologjia e vlerësimit të cilësisë, rezulton të jetë e përcaktuar në Politikën e zhvillimit të cilësisë në UMT. Kjo metodologji përmban instrumenta të ndryshëm vlerësimi, si pyetësorët, monitorimi i

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 82

	<p>proceseve mësimore, rezultatet e punës kërkimore shkencore të stafit akademik.</p> <p><i>Aneksi Nr.62, Rregullorja e NJSBC.pdf</i></p>		
<p><b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Nga informacioni i siguruar gjatë vizitës në UMT, rezultoi se informacioni i siguruar për cilësinë, nga instrumentat e mësipërm, mblidhet nga strukturat respektive, analizohet dokumentohet dhe iu përcillet organeve vendimmarrëse. Nga RVB dhe nga takimet me drejtues të njësisë kryesore dhe asaj bazë, rezulton se realizohet analizë vjetore e aktivitetit mësimor dhe kërkimor shkencor të departamentit, për të identifikuar problematikat që mund të jenë shfaqur dhe për ti adresuar ato.</p> <p>Kjo analizë bëhet pjesë integrale e raportit vjetor në nivel institucioni si plotësim edhe i detyrimit ligjor për cdo IAL.</p> <p><i>Aneksi Nr.33,Raporti mbi aktivitetin kërkimor-shkencor të stafit akademik të FE.pdf</i></p> <p><i>Aneksi Nr.49, Analiza e NJSBC për pyetësorët S1-2021-2022.pdf;</i></p>		
<p><b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>

### Standardi VI.3

**Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Nga vizita në institucion si dhe nga RVB, GVJ konstaton se NJSBC në nivel institucioni në koordinim me njësinë bazë, realizojnë në mënyrë periodike vlerësime të brendshme. UMT e bën këtë vlerësim pjesë të vetëvlerësimeve periodike për qëllim të akreditimit të programit.</p> <p>GVJ konstaton se rolin kryesor në nivel programor për vlerësimin e programit tëstudimit Msc. në Menaxhim në Inxhinieri, e ka departamenti përgjegjës, ai i Informatikës Ekonomike.</p> <p>Ky vlerësim bëhet kryesisht për për planet mësimore, për syllabuset, për cilësinë e mësimdhënies etj. Prej NJSBC sigurohet informacion nga pyetësorët, që adresohen dhe kërkojnë informacion, për lëndët e PS Msc. Msc. në Menaxhim në Inxhinieri, si dhe për pedagogët e këtyre lëndëve.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën</p>	

e fushës akademike të programit të studimit.	<p><i>Aneksi Nr.33,Raporti mbi aktivitetin kërkimor-shkencor të stafit akademik të FE.pdf</i></p> <p><i>Aneksi Nr.49, Analiza e NJSBC për pyetësorët S1-2021-2022.pdf;</i></p> <p><i>Aneksi Nr.75, Model i syllabusit.pdf;</i></p> <p>GVJ konstatoi se UMT në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së PS Msc. në Menaxhim në Inxhinieri, përdor metoda të drejtpërdrejta të vlerësimit si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a- Nëpërmjet monitorimit nga departamenti, vlerëson cilësinë e mësimdhënies dhe vëzhgime në auditor</li> <li>b- Kontroll të syllabuseve të lëndëve</li> <li>c- Përshtatje e planeve mësimore</li> <li>d- Vlerësim të organizimit të provimeve dhe detyrave të kursit</li> </ul> <p>GVJ konstatoi se UMT në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së PS, Msc. në Menaxhim në Inxhinieri, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>e- Sondazhe me studentët e programit, cdo semestër para fillimit të sezonit të provimeve</li> <li>f- Organizon takime me studentët, për tu thelluar në gjetjet e pyetësorëve, ku shpesh monitorimet planifikohen pas realizimit të takimeve me studentët</li> <li>g- Komisione Ad-hoc monitorimi, vlerësimi</li> <li>h- Pyetësor apo takime me studentët Alumni</li> </ul> <p><i>Aneksi Nr.14, Rrjeti Alumni UMT.pdf; Aneksi Nr.48, Model i pyetësorit të studentit per lendenpedagogun.pdf</i></p> <p><i>Aneksi Nr.33,Raporti mbi aktivitetin kërkimor-shkencor të stafit akademik të FE.pdf</i></p>		
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi VL4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>


<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se UMT ka NJSBC, si njësi qendrore në nivel institucioni, që ka të sanksionuar në statutin e UMT, detyrimin për implementimin e procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë në UMT.</p> <p>NJSBC e garanton rolin e saj në bashkëpunim me njësinë bazë dhe atë kryesore, që janë përgjegjëse për programin e studimit Msc. Menaxhim në Inxhinieri. Vendimmarrjet për përmirësimin e cilësisë pas rezultateve të vlerësimit, merren dhe zbatohen kryesisht në nivel departamenti dhe njësie kryesore, sic janë rishikim planesh mësimore dhe syllabusesh, apo mbarëvajtja e mësimdhënies.</p> <p>Referuar takimeve me studentët dhe GVB, studentët janë të përfshirë dy herë në vit në plotësimin e pyetësorëve. Studentët e programit rezultuan gjithashtu pjesë edhe GVB. Studentët e UMT, kanë edhe përfaqësuesin e tyre në NJSBC, që mbulon komunikimin me studentët për proceset vlerësuese.</p>		
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>GVJ konstatoi se edhe nëpërmjet rrjetit Alumni që institucioni ka, nëpërmjet pyetësorëve me Alumni, si dhe takimeve që ka zhvilluar me ta, institucioni siguron informacion për përmirësimin e programeve.</p> <p>Pyetësorët zhvillohen anonim, duke ruajtur anonimitetin e përgjigjeve të studentëve. Departamenti përveç analizës së problematikave të hasura në tërësi, iu vendos në dipozicion në mënyrë individuale stafeve akademike të programit, rezultatet e vlerësimeve që studentët kanë bërë për lëndët që ata mbulojnë, pas përfundimit të procesit të provimeve dhe dorëzimit të procesverbaleve.</p>		
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Diskutimet zhvillohen mbi problematikat e mundshme, duke shmangur diskriminimin apo pabarazinë, kundrejt stafit akademik dhe studentëve.</p>		
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p><i>Aneksi Nr.14, Rrjeti Alumni UMT.pdf;</i> <i>Aneksi Nr.48, Model i pyetësorit të studentit per lendenpedagogun.pdf</i></p>		
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>		<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi VI.5**

**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	GVJ referuar DVV dhe webit zyrtar të UMT, konstaton se politika, e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.  NJSBC mbështet në Politikën e Sigurimit të Brendshëm të cilësisë, për të cilën studentët informohen nëpërmjet guidës së studentit, webit zyrtar apo stafit të NJSBC.  GVJ konstatoi se UMT harton raportet e vlerësimit vjetor të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Raporti respekton lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. Informacioni nga takimet me stafin akademik, iu jepet individualisht stafeve për të respektuar të drejtën e informimit si dhe për të adresuar problematikat, por njëkohësisht edhe në respekt të integritetit të secilit.			
<b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Nga vizita në institucion, rezultojnë se UMT organizon trajnime me stafin rreth proceseve të vetëvlerësimit apo vlerësimit të jashtëm. Nëpërmjet stafeve administrative të NJSBC dhe studentit pjesë e NJSBC, studentët marrin informacion për pyetësorët dhe synohet që të nxitet angazhimi i stafeve dhe studentëve si dhe ndërgjegjësimi për sigurimin e cilësisë në institucion			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	<i>Aneksi Nr.33, Raporti mbi aktivitetin kërkimor-shkencor të stafit akademik të FE.pdf</i> <i>Aneksi Nr.58, Aktivitete me studentët.pdf;</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Përmbushet		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
	Plotësisht	Kryesisht		
				X




**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit Master i Shkencave në “Menaxhim në Inxhinieri” të institucionit të arsimit të lartë Universiteti Metropolitan Tirana**

**Pikat e forta dhe afirmime**

1. Bashkëpunimi efektiv i strukturave drejtuese, akademike dhe mbështetëse në shërbim të programit të studimit
2. Sistemi i informacionit i integruar dhe efektiv
3. Kurrikula bashkekohore
4. Staf akademik me tituj dhe grada perfshire edhe staf akademik te huaj me kontrate me eksperience nderkombetare mësime
5. Procedura rekrutimi, transparente dhe te orientuara drejt cilesise
6. Sistemi i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë me mekanizma të diversifikuar dhe efektivë të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë
7. Struktura mbështetëse efektive për studentët, për informimin e tyre rreth programit, mundësive të punësimit si dhe për programet e shkëmbimit te tyre.

**Pika të dobta**

1. Hapësira fizike dhe kapacitetet pritëse të bibliotekës konsiderohen të pamjaftueshme për të plotësuar kërkesat e studentëve të të gjithë programeve që UMT ka.

**Rekomandime**

1. Hapësira fizike dhe kapacitetet pritëse të bibliotekës konsiderohen të pamjaftueshme për të plotësuar kërkesat e studentëve të të gjithë programeve qe UMT ka. GVJ sugjeron shtimin e kapaciteteve fizike, posteve pritëse dhe kompjuterave në bibliotekën e UMT



**Conclusions of the evaluation of study program Master of Science in “Management in Engineering” of the Metropolitan Tirana University**

**Strengths and Affirmations:**



1. Effective cooperation of management, academic and support structures in the service of the study program.
2. Integrated and effective information system.
3. Contemporary curriculum.
4. Academic staff with titles and ranks, including foreign academic staff with contracts with international teaching experience.
5. Recruitment procedure, transparent and oriented towards quality.
6. Internal Quality Assurance System with diversified and effective quality monitoring and evaluation mechanisms.
7. Effective support structure for students, for informing them about the program, employment opportunities as well as for their exchange programs.

**Weaknesses:**

1. The physical space and hosting capacities of the library are considered insufficient to meet the demands of students of all the programs.

**Recommendations:**

1. The physical space and hosting capacities of the library are considered insufficient to meet the demands of students of all the programs that UMT has. GVJ suggest the addition of physical capacities, reception desks and computers in the UMT library.



**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Përmbushen plotësisht	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				<b>X</b>

